



Laboratori i kontrollit ushqimor në Durrës: Deda: I gjithë sistemi sipas standardeve të BE-së

Faqe 4



Zhvillimi i agroturizmit, fuqi për rivitalizimin e fshatrave

Faqe 7



Dita Botërore e Bletëve, MBZHR: Mbështetje për rreth 2 681 bletarë në vitin 2022

Faqe 5



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit maj 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 462  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# KASH PROGRAM TË MIRËFILLTË PËR ULLIRIN DHE VAJIN E ULLIRIT

## KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR INICIOI DHE PO E ZBATON PROGRAMIN "ULLIRI DHE CILËSIA E VAJIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI"

Objektivat e programit: Krijimi i një praktike të qëndrueshme pune, për hartimin e një modeli eficient dhe oferte gjithëpërfshirëse, për të ndihmuar e nxitur procesin e eksportit të vajit të ullirit nga Shqipëria për në vendet e BE dhe më gjerë, që ofrojnë çmime më të mira

### RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Panairi i bujqësisë në Lushnje, RisiAlbania diskuton mbi standardet e cilësisë



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri

RisiAlbania Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft Confédération suisse Confédération Svizzera Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2



### ITC

Schweizerische Eidgenossenschaft Confédération suisse Confédération Svizzera Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO Государственный Секретариат Швейцарии по Экономике SECO

International Trade Centre

Përmirësimi i konkurrencës në agrobiznes, starton më 7 Qershor në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë, projekti i mbështetur nga Zvicra

Faqe 6

### ARSIMI PROFESIONAL

Tri shtyllat kryesore në fokus të RisiAlbania-s, për punësimin e të rinjve

Faqe 4

### KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për prodhuesit e perimeve Fq.11
- Ushqimet e kombinuara dhe leverdia praktike e përdorimit të tyre në të ushqyerit e blegtorisë Fq.11
- Ndikimi i blegtorisë në mjedis - Nga: Flutura Sala, Albi Shehu Fq.12
- Kalendari bujqësor, qershor 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Krifca në Romë: Bashkëpunim dhe marka të përbashkëta me Italinë



Faqe 2

### INVESTIME

Pajisje të teknologjisë së lartë me mbështetjen e IPARD, modeli i fermës ku po orientohet blegtoria



Faqe 10



## RISI ALBANIA

# Panairi i bujqësisë në Lushnje, RisiAlbania diskuton mbi standardet e cilësisë

Një konferencë mbështetur nga RisiAlbania, një projekt i zbatuar nga Helvetas, u zhvillua në panairin "Agriculture Days" të organizuar nga Iceberg Exhibitions në Lushnje. Konferenca përfshinte dy panele mbi "Standardet Ndërkombëtare të Cilësisë për Fruta dhe Perime" dhe "Teknologjitë Inovative në Agribusiness", me pjesëmarrjen e ekspertëve të Grupit Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P.

Panelistët theksuan rëndësinë e respektimit të standardeve ndërkombëtare të cilësisë dhe sociale, si Global G.A.P, Grasp, local.g.a.p, FSSC 22000 dhe më shumë, për të rritur konkurrueshmërinë e frutave dhe perimeve shqiptare në tregun global. Ekspertët gjithashtu diskutuan potencialin e teknologjisë për

të revolucionuar industrinë e agribusiness-it, duke theksuar raste të suksesshme të zbatimit të teknologjive inovative.

për të arritur ekselencën në standardet e cilësisë. Eventu ofroi një platformë interesante për të shkëmbyer dije dhe ide



Kjo konferencë tregoi një angazhim për të promovuar agribusiness-in shqiptar dhe

për përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe qasjen në tregjet me vlerë të lartë.

# Shqipëri-Zvicër, Memorandum Bashkëpunimi në fushën e turizmit

Shqipëria dhe Zvicra nënshkruan në Zyrih një Memorandum Bashkëpunimi (MoU)

në Bernë, Ilir Gjoni dhe Pascal Prinz, Drejtor i Nismave Globale në Turizmin Zviceran (ST).

teve për turistët shqiptarë dhe zviceranë në bashkëpunim me federatat lokale të agjencive të turizmit, përgjegjëse për mbështetjen e turizmit të jashtëm.

Dy vendet do të shkëmbejnë informacion mbi aktet ligjore që rregullojnë turizmin, statistikat mbi turizmin dhe përvojën e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve turistike.

Një pikë tjetër e rëndësishme e kësaj marrëveshje është dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore të angazhuara në trajnimin e personelit profesional në fushën e turizmit.

Gjithashtu, Shqipëria dhe Zvicra do të ndihmojnë njëra-tjetrën në organizimin e ekspozitave dhe forumeve të turizmit, si dhe të vizitave informative për përfaqësuesit e turizmit dhe medieve të të dy vendeve, me qëllim njohjen me infrastrukturën dhe produktet turistike.

Gjatë vizitës, Sommarga shoqëroi delegacionin shqiptar në ambientet e Organizatës Kombëtare dhe Marketingut të Turizmit Zviceran.



në fushën e turizmit.

Marrëveshja për palën shqiptare u nënshkrua nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit të Shqipërisë (AKT), Zana Çela-Rama, ndërsa për palën zvicerane nga Federico Sommaruga, Drejtor i Tregjeve në Zhvillim dhe Projekteve Speciale në Turizmin Zviceran (ST).

I pranishëm gjatë firmosjes ishte Ambasadori i Shqipërisë

Sipas kësaj marrëveshje Shqipëria dhe Zvicra do të forcojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e turizmit, duke përfshirë:

- Asistencën në vendosjen e kontakteve me organizatat përkatëse, qasjet ndaj turizmit të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit në zonat malore dhe parqet kombëtare,

- Asistencën për zhvillimin dhe promovimin e produk-

# Programi zvicerano-austriak për Zhvillimin Rajonal

Programi i përbashkët zvicerano-austriak për Zhvillimin Rajonal përfundoi dhe ne nje takim u festuan arritjet e tij me partnerët nga qeveria dhe bashkitë. "Për çdo vend që aspirojnë të zhvillojnë potencialin e vet plotësisht dhe të anëtarësohet në Bashkimin Europian, është thelbësore që të përgatitet dhe të investojë tek zhvillimi rajonal" - Ambasadorja zvicerane Ruth Huber. Cilat janë disa nga kontributet e programit?



• Aftësimi i departamentit

(Vijon në faqen 6)

## MBZHR

# AZHBR: Mbi 11 mijë karta të naftës falas të shpërndara deri tani

AZHBR njoftoi se vazhdon mbështetjen me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, nga Skema Kombëtare 2023.

Sipas AZHBR-së, deri më sot janë 11,441 fermerë të cilët janë pajisur me kartat e naftës falas, për një sasi prej 2,420,206 litrash.

Përmes kësaj mase fermerët përfitojnë ulje të kostove të punimeve sipas kulturave bujqësore të mbjella, duke ndikuar në rritjen e prodhimit.

Sasia e naftës së përcaktuar mund të tërhiqet deri në datën 31 dhjetor 2023.

Qeveria po zbaton prej dy vitesh skemën mbështetëse të naftës pa taksë për bujqësinë, duke lehtësuar buxhetet e fermerëve në punët e bujqësisë.

Buxheti adresuar kësaj skeme ka ardhur në rritje, teksa është rritur edhe interesi i fermerëve për të përfituar nga kjo masë.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, krahasuar me vitin 2021, këtë vit numri i aplikantëve në

skemën e naftës pa taksë për bujqësinë është rritur në 50 mijë nga 20 mijë aplikantë që ishin një vit më parë. Teksa është dyfishuar apo trefishuar edhe buxheti për naftën për bujqësinë.

Kjo skemë po vazhdon zbatimin me sukses dhe sot është nevojë shumë e madhe duke parë dhe rritjen e çmimit të naftës në treg. Skema e naftës pa taksë për fermerin lehtëson kostot e prodhimit, teksa synon mbështetjen e prodhimit vendas bujqësor.

Ekspertët e vlerësojnë

skemën e naftës si mbështetjen më të madhe që i është dhënë ndonjëherë fermerëve nëpërmjet skemës kombëtare.

Këtë vit qeveria ka dhënë miliardë lekë për naftën, ndërsa skemat e tjera mbështetëse janë të qëndrueshme prej disa vitesh, siç është ajo për bletarinë, blegtorinë e serrat.

Deri tani janë shpërndarë mbi 8 milionë litra naftë. Ndërsa janë 36 mijë fermerët përfitues të naftës, deri në fund të shtatorit.



# Krifca në Romë: Bashkëpunim dhe marka të përbashkëta me Italinë

"Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Italisë sot është në maksimumin që ka qenë ndonjëherë, teksa synojmë të ardhmen me produkte të përbashkëta dhe etiketa të përbashkëta: "Made in Albania" dhe "Made in Italy".

Kështu u shpreh ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca, e cila me ftesë

të partneriteteve midis kompanive tona dhe ndërmarrjeve italiane që operojnë në industrinë ushqimore".

Ministria Krifca u ndal në përparësinë e agjendës së bashkëpunimit me Italinë, për më shumë sipërmarrje të përbashkëta, që kombinojnë avantazhet krahasuese nga të dy brig-

përtej kufijve tanë.

Sipas saj, vlera e shtuar e këtij bashkëpunimi duhet të qëndrojë pikërisht në kombinimin e avantazheve të dy vendeve dhe promovimin të produkteve finale.

"Një dekadë më parë eksportet tona arrinin mesatarisht 100 milionë euro. Vitin e kaluar kemi eksportuar me sukses mbi 500 milionë euro produkte bujqësore. Rritja e jashtëzakonshme e ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe e sektorit bujqësor në veçanti i detyrohet shumë faktorëve të tilla si skema e subvencionimit nga buxheti i shtetit, si dhe programi IPARD i financuar nga qeveria shqiptare dhe nga Bashkimi Europian, që fuqizon drejtpërdrejt fermerët dhe eksportuesit e suksesshëm", nënvizoi Krifca.

Ne, vijoi Krifca, kemi lehtësuar gjithashtu procesin e mekanizimit duke eliminuar të gjitha taksat për shumicën e makinerive të importuara dhe mjetet e transportit.

Ministria Krifca deklaroi se "për të arritur objektivin tonë prej 1 miliard euro eksporte brenda vitit 2030, nuk mund të anashkalojmë asnjë mundësi për t'u rritur dhe për të bashkëpunuar".

Pjesëmarrja e ministres Krifca në Asamblenë Ndërkombëtare të Tregjeve të Fermerëve ka ardhur si ftesë e ministrit italian të Bujqësisë, Francesco Lollobrigida.



të ministrit italian të Bujqësisë, Francesco Lollobrigida, mori pjesë në Asamblenë e Koalicionit të Tregjeve të Vogla për Fermerët, që po zhvillohet në Romë.

Ministria vuri në dukje se "Italia është është partneri më i rëndësishëm tregtar i Shqipërisë, me një vëllim shkëmbimesh mbi 4 miliardë euro në vitin 2022, ku mbi 10 % e volumit tregtar i përket mallrave bujqësore".

Krifca tha se "vitet e fundit ne kemi qenë dëshmitarë të një rritjeje të jashtëzakonshme

jet e Adriatikut.

"Ajo që shoh në të ardhmen është bashkëpunimi dhe markat gjithnjë e më shumë të përbashkëta. Shoh produkte të përbashkëta dhe pse jo, etiketa të përbashkëta: "Made in Albania" dhe "Made in Italy", tha Krifca.

Ministria Krifca vuri në dukje se bashkëpunimi me Italinë nis në ndërtimin e një zinxhiri vlerash, që fillon me të korrat dhe përfundon me përsosmërinë e produkteve italo-shqiptare që mund të jenë konkurruese



## KASH PROGRAM TË MIRËFILLTË PËR ULLIRIN DHE VAJIN E ULLIRIT

# KASH INICIOI DHE PO E ZBATON PROGRAMIN “ULLIRI DHE CILËSIA E VAJIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI”

*Objektivat e programit: Krijimi i një praktike të qëndrueshme pune, për hartimin e një modeli eficient dhe oferte gjithëpërfshirëse, për të ndihmuar e nxitur procesin e eksportit të vajit të ullirit nga Shqipëria për në vendet e BE dhe më gjerë, që ofrojnë çmime më të mira*

Iniciativa u muar nga KASH për shkak të situatës problematike të krijuar për mungesë organizimi dhe eficientë të kësaj pasurie kombëtare, që së afërmi parashikohet të shkojë drejt 12 milion rrënjë ullin në prodhim. Gjithashtu ndikim pati dhe kërkesa masive për mbështetje e asistencë në formalizimin e tregut të vajit të ullirit e rreth 118 mijë familjeve fermere, që kultivojnë bimën e ullirit. Fermerët po vijnë në shtojnë mbjelljet dhe do ju rezultojnë në të ardhmen teprica edhe më të mëdha vaji ulliri për treg. Por për ta tregtuar vajin veçanërisht në periudhat pik të prodhimit janë ndeshur me vështirësi e probleme që të vetëm nuk po u gjenin dot zgjidhje dobiprurëse.

Praktika e ndjekur deri tani nga prodhuesit e ullirit, që gjithë tepricën e vajit mbas përpunimit të ullirit e marrin në shtëpi dhe përpunon ta tregtojnë secili individualisht nuk ka rezultuar eficiente dhe nuk po funksionon për shumë familje. Gjithashtu praktika po na tregon se familjet fermere në nevojë për mjete financiare dhe emigrantët dëshirojnë që ta shesin tepricën e vajit menjëherë sapo e prodhojnë atë në periudhën tetor – dhjetor. Duke krijuar kështu një situatë të pafavorshme për ta në treg, në të cilin oferta rezulton më e madhe se kërkesa dhe natyrisht çmimet e vajit ulen ndjeshëm shpesh edhe nën kosto. Por edhe atyre familjeve fermere që nuk kanë emergjencë për shitje dhe e mbajnë vajin në shtëpi, përsëri vajit me kalimin e kohës i ulen cilësinë dhe rrjedhimisht i ulen edhe çmimi shitjes. Shkaku është se shumë prej tyre nuk arrijnë ta ambalazhojnë vajin në pajisje qelqi apo inoksi dhe ta ruajnë në ambiente të klimë të përshtatshme, kushte të nevojshme që vaji të ruajë cilësinë e mirë të tij për një periudhë kohe më të gjatë, që ta tregtojnë tepricën e vajit në momentin e duhur. Por përsëri nuk duhet të harrojmë që edhe këtë moment dhe proces e kondicionon bursa dhe tregu, pra kërkesë-oferta, jo nevoja apo dëshira e fermerëve për ta shitur me çmimin e duhur. Edhe këtyre familjeve shpesh u zë sezoni i ri i prodhimit një sasi vaji stok nga sezoni i mëparshëm dhe shpesh disa edhe nga padija ndodh që e përziejn prodhimin e ri cilësor me prodhimin e vjetër që e ka humbur cilësinë, duke dëmtuar kështu edhe cilësinë e prodhimit të ri. Kjo mënyrë të vepruarit e ka dëmtuar rëndë tregtimin dhe imazhin për cilësinë e vajit të ullirit

në Shqipëri që në nisje të sezonit. Supermarketet kryesore në Shqipëri, referuar statndarëve të kërkuara prej tyre, për ambalazhimin, certifikimin, cilësinë, sasinë dhe ritmin e furnizimit, të cilat nuk mund të plotësohen nga tregtuesit aktualë individualë të vajit të ullirit, kryesisht shesin për tregun e vendit sasi të konsiderueshme vaj ulliri të importuar. Gjithashtu po të shtosh edhe faktin që paketa fiskale në fuqi është penalizuese dhe po rezulton e padobishme edhe për ato subjekte grumbulluese të vajit të ullirit vendas, të cilët blejnë nga shitësit individualë, sepse nuk u rimbursohet TVSH për blerjen nga fermerët vendas dhe nga ana tjetër u kërkohej padrejtësisht të paguajnë TVSH në shitje në masën 20 %.

Problemeve të mësipërme që ndikojnë negativisht në cilësinë e vajit po t'i shtojmë edhe disa probleme të tjera që ekzistojnë në praktikë si ato të infeksionit nga miza e ullirit, spërkatjet e ndryshme me disa pesticide dhe insekticide që kanë karencë të gjatë dhe dëmtojnë cilësinë, mosvjeljen në kohë dhe me mjetet e duhura, transportin me ambalazh të papërshtatshëm, mospërpunimin në kohë etj., situata bëhet akoma më e vështirë dhe më komplekse për t'u futur në rrugën e zgjidhjes vetëm nga fermerët dhe në mungesë të një koordinimi midis subjekteve publike dhe atyre private të prodhuesve, përpunuesve, grumbulluesve, tregtuesve dhe konsumatorëve.

KASH me synim për të futur në rrugën e zgjidhjes problemin e krijuar me “Ullirin dhe cilësinë e vajit të ullirit në Shqipëri” mbas disa analizave dhe konsultimeve me Këshillin e Ekspertëve të Agrobiznesit mbledhi Komitetin Ekzekutiv të KASH dhe vendosi të iniciojë dhe zbatojë një program pune të dedikuar ullirit dhe vajit të ullirit, të cilin ia prezantoi Ministres Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Znj. Frida Krifca. Ministria Krifca e mirëpriti dhe përkrahu propozimin, e vlerësoi seriozisht situatën, u angazhua që do të negocionte pa humbur kohë me homologët e vet Italianë dhe Spanjollë, me Qendrën Ndërkombëtare për Studime të Avancuara Agronomike Mesdhetare CIHEAM në Bari, Itali si dhe me Projektin RisiAlbania, Gjithashtu udhëzoi AREB, QTTB dhe institucionet e tjera të varësishme që ta asistojnë me prioritet dhe premtori që ky program do të jetë në vëmendjen dhe nën kujdesin e vaçantë të Saj. Ministria Krifca e ka përm-

bushur deri më tani premtimin e dhënë, kabiseduar me homologët e vet spanjollë dhe ata Italianë. Ky i fundit erdhi edhe në Shqipëri me një grup ekspertësh dhe përfaqësues të biznesit Italian të vajit të ullirit, Ai u angazhua të mbështeste subjektet e biznesit Italian për importin e tepricave të vajit të ullirit nga Shqipëria dhe puna ka filluar. Italia është aktualisht importuesi më i madh i vajit të ullirit nga Shqipëria. Gjithashtu edhe nga CIHEAM Bari ka filluar asistencën për ullirin. Projekti RisiAlbania ka finalizuar tashmë kontratën me Komitetin Ekzekutiv të KASH, për mbështetjen logjistike dhe financiare për zbatimin në vijim të këtij programi specifik.

Komiteti Ekzekutiv i KASH në kuadër të koordinimit ka përfunduar edhe procedurat ligjore të bashkëpunimit me ekspertët më të mirë në vend për zbatimin e këtij programi. Gjithashtu me shoqatën e Përpunuesve të ullirit për vaj (AOA), Kooperativen financiare FED Invest shkk, që administrojnë Platformën Elektronike ABA Online. Si dhe po vijon punën për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e grumbulluesve dhe eksportuesve të vajit të ullirit, për ta grumbulluar e shitur tepricat e vajit të ullirit si në tregun e vendit dhe për eksport.

Grupi punës është i bindur tashmë se për të realizuar me sukses dhe në kohën e duhur qëllimin dhe objektivat e këtij programi përveç vlerësimit, impenjimit dhe angazhimit maksimal kërkohet edhe demonstrimi i një integriteti të lartë profesional dhe moral gjatë procesit të zbatimit për realizimin e qëllimit, objektiveve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, si dhe një formulim bindës dhe korrekt i konkluzioneve përfundimtare të programit. Kapaciteti profesional i të gjithë anëtarëve të grupit të punës është tashmë fakt se është i nivelit më të lartë që kemi në vend. Formulimi dhe zbatimi i programit u jep atyre mundësinë që ta demonstronjë integritetin e tyre profesional e moral dhe t'i bindin fermerët prodhues, grumbulluesit, përpunuesit, eksportuesit duke u ballafaquar në terren me zgjidhjet që japin dhe modelin që propozojnë, për të futur në rrugën e zgjidhjes së qëndrueshme problemet e ullirit dhe cilësisë së vajit të ullirit, që ata realisht i shqetësojnë, por që deri më tani nuk po u japin dot zgjidhje të vetëm. Gjithashtu grupit të punës nuk i mjafton vetëm integriteti i lartë profesional dhe moral nga ata kërkohet edhe:

Përdorimi gjerësisht në procesin e zbatimit të programit i mjeteve dhe metodave inovative bashkëkohore, bindëse për të gjithë aktorët pa përjashtim, përmes përdorimit të procesit të digjitalizimit, për realizimin në një kohë sa më të shpejtë të qëllimit dhe objektivave të këtij programi. Në program parashikohet që të përfshihen të gjitha zonat prodhuese të ullirit dhe vajit të ullirit. Përzgjedhja ku do të realizohen demonstrimet është parashikuar të bëhet kryesisht në qendrat e përpunimit të ullirit dhe grumbullimit të vajit dhe në një mënyrë mjaft transparente, përmes përdorimit të platformës elektronike ABA Online. Radha e punës vendoset duke patur si prioritet sasinë e vajit dhe numrin e pjesëmarrësve të interesuar për të kontribuar në këtë program. Grupi i punës ka dy kategori kryesore ekspertësh, ka degustuesit dhe ekspertët e kryerjes së analizave më të detajuara kimiko fizike.

Degustuesit e vajit realizojnë degustimin dhe japin rezultatin në prani poseduesit të vajit dhe pjesëmarrësve të tjerë në takim. Analizuesit bëjnë analiza të shpejta kimike me instrumente bashkëkohore dhe japin rezultatin paraprak në prani të poseduesit dhe pjesëmarrësve të tjerë. Kjo mënyrë pune i shërben transparencës dhe eficientësisë së realizimit të këtij programi.

Transparenca e plotë e aktivitetëve të grupit e shoqëruar edhe me konfidencialitetin për të dhënat sensitive, që do të rezultojnë gjatë procesit të vepërimit praktikë, për të gjithë aktorët dhe pjesëmarrësit e grupit të punës në këtë program, është një kërkesë tjetër e domosdoshme që parashikohet dhe zbatohet nga grupi punës në këtë program. Asnjë e dhënë sensitive nuk do të publikohet nga programi pa miratimin e secilit që ka të drejtën e dhënies së miratimit.

Subjekte të interesuar për t'i dhënë zgjidhje të qëndrueshme problemeve komplekse të ullirit dhe cilësisë së vajit të ullirit në Shqipëri, përveç Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) janë të interesuar edhe rreth 118 mijë familje fermere, subjektet e përpunimit të ullirit për vaj, grumbulluesit, eksportuesit, konsumatorët, Shoqatat e biznesit, Agjensitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Agjensia Kombëtare e Ushqimit (AKU), Agjensia

e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR), Projekti RisiAlbania etj. Komiteti Ekzekutiv i KASH vëmendje dhe vlerësim të posaçëm në zbatimin e programit i ka kushtuar procesit të kooperimit, koordinimit dhe bashkëveprimit të subjekteve të sipërcituara, për të mundësuar kontributin dhe një vepërimitarë eficientë e të gjithë aktorëve të interesuar dhe grupit të punës.

Fakti që grupi punës punon në front, duke koordinuar në kohë vepërimitarë dhe kontributin e të gjithë aktorëve në çdo fazë të zbatimit të programit, konsiderohet si një nga elementet kyç dhe mjaft i domosdoshëm nga Komiteti Ekzekutiv i KASH në arritjen e suksesit për të realizuar në një kohë sa më të shkurtër qëllimin dhe objektivat e programit. Programi i platformës elektronike ABA online na e mundëson si transparencën dhe punën eficientë në front.

Programi parashikon në mënyrë specifike dhe të detajuar detyrat e secilit subjekt të përfshirë në realizimin e këtij programi.

Grupi qendror i punës organizon në front dhe koordinon vepërimitarë trajnues për mënyrën e zbatimit të programit, realizon degustimin dhe analizat, përpunon të dhënat dhe harton një model të përshtatshëm, që u jep zgjidhje më eficientë problemeve, si dhe formulon treguesit kryesorë të ofertës së vajit të ullirit në Shqipëri si për tregun e vendit dhe atë për eksport.

Shoqata AOA komunikon me subjektet përpunuese të ullirit dhe këta të fundit me prodhuesit e ullirit klientë të tyre, për t'u spjeguar qëllimin dhe objektivat e programit të ullirit dhe vajit të ullirit.

FED Invest shkk realizon programin e dedikuar digjital për ullirin dhe vajin e ullirit në Shqipëri përmes Platformës Elektronike ABA online dhe angazhon strukturat e veta në të gjithë vendin për përdorimin eficient të programit nga të gjithë aktorët pjesëmarrës në program.

Subjekteve prodhuese, grumbulluese dhe eksportuese të vajit t'u krijohen kushte dhe t'u lehtësohet procesi komunikimit, që të diskutojnë me pronarët e vajit për detaje mbi kontratat, për sasinë, çmimet e grumbullimit të vajit ullirit etj. KASH sensibilizon dhe nxit shoqatat anëtare, median e shkruar dhe atë elektronike, për një pjesëmarrje të gjerë në realizimin e këtij programi, të fermerëve prodhues të ullirit, dhe subjekteve të tjera publike

dhe private, të angazhuara në realizimin e qëllimit dhe objektivave të këtij programi.

MBZHR vijon punën me homologët spanjollë dhe Italianë për të lehtësuar procedurat e mbështetur eksportin e vajit të ullirit nga Shqipëria, si dhe udhëzon institucionet e varësishme për të mbështetur e asistuar me prioritet realizimin e programit sipas kompetencave dhe fushës së tyre të veprimit.

Projekti RisiAlbania mbështet me logjistike dhe financiarisht, si dhe monitoron realizimin e programit “Ulliri dhe vaji ullirit në Shqipëri”.

Mesazhet që jep dhe do të vijojë të japi grupi punës dhe subjektet e tjera të interesuara për realizimin e programit janë shumë, por po veçojmë disa prej tyre:

## Qëllimi:

Të evidentojë përmes fakteve konkrete problemet që ekzistojnë në të gjithë zinxhirin, të analizojë e diskutojë zgjidhjet dhe t'i ballafaqojë ato në terren me të gjithë aktorët e interesuar. Të prodhojë një raport për të ndërgjegjësuar subjektet pjesëmarrëse në program si private dhe ato publike, për të shtuar investimet, përmes përdorimit të instrumentave novative e digjitale bashkëkohore, si dhe një mënyrë pune eficientë, për të përballuar situatën e lehtësuar zgjidhjen e problemeve konkrete të çdo hallke, që krijohen veçanërisht në periudhat pik të prodhimit të vajit të ullirit.

## Objekti:

Krijimi i një praktike të qëndrueshme pune, për hartimin e një modeli eficient dhe oferte gjithëpërfshirëse, për të ndihmuar e nxitur procesin e eksportit të vajit të ullirit nga Shqipëria për në vendet e BE dhe më gjerë, që ofrojnë çmime më të mira.

## Metodologjia:

Kooperimi, koordinimi, puna në front, përdorimi teknologjisë novative dhe digjitale, ballafaqimi i të gjithë aktorëve në të gjitha hallkat e zinxhirit me faktet konkrete në terren.

## Negociatat:

Diskutimet për detaje të kontratave individuale të shitjes së vajit si çmimi, sasia, koha e lëvrimit, garancitë dhe mënyra e pagesës, lloji ambalazhit e transportit etj nuk janë objekt i anëtarëve të grupit të punës. Ato janë objekt ekskluziv i pronarit apo poseduesit të vajit të ullirit dhe grumbulluesit apo eksportuesit të tij.



## BE, mbi 2 milionë euro investim në bujqësi dhe zhvillimin rural në qarkun e Dibrës

Delegacioni i Bashkimit Evropian thekson se, panairi në Peshkopi ishte një shembull konkret sesi mbështetja e BE-së i ka ndihmuar fermerët vendas në qarkun e Dibrës të prodhojnë produkte cilësore "Made in Albania".

Delegacioni i BE-së ishte i pranishëm në këtë panair ku patën mundësinë të shkëmbejnë me biznesin vendas të turizmit mbi sfidat me të cilat përballen dhe se si mund t'i mbështesë BE-ja.

"Nga gastronomia e shkëlqyer, tek mikpritja e ngrohtë në bujtinat tradicionale, guidat turistike të certifikuar për shtigje me biçikleta, rafting dhe hapja e shtigjeve të reja ecjeje, ata janë të përkushtuar të krijojnë një eksperiencë origjinale dibrane", thekson Delegacioni i BE-së, në postimin në rrjetet sociale.

Delegacioni i BE-së bën të ditur se, vetëm nëpërmjet programit IPARD, BE-ja po investon më shumë se 2 mil-

"Ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë Shqipërinë në zhvillimin e bujqësisë dhe zonavave rurale dhe përmirësimin



ionë euro në bujqësi dhe zhvillim rural në qarkun e Dibrës, nëpërmjet 25 granteve, nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt fermerët dhe sipërmarrësit.

e jetesës së njerëzve që jetojnë në hapësirën rurale", shprehet Delegacioni i BE-së, teksa ka publikuar edhe foto nga panairi në Peshkopi.

## Mbështetje nga Skema Kombëtare, "Mare Adriatik" investon në dhoma frigoriferike bashkëkohore

"Mare Adriatik" është një kompani në Vaun e Dejës, e specializuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve të

ka sjellë për tregun vendas një gamë të gjerë prodhimesh, të cilat eksportohen edhe në tregun e jashtëm.

Adriatik" ka zgjeruar ambientet e grumbullimit dhe të ruajtjes së produkteve, duke investuar në dhoma frigoriferike të përmirësuar standardet e prodhimit.

Peshkimi është një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë shqiptare dhe si i tillë është përkrahur vazhdimisht prej skemave subvencionuese.

Në Skemën Kombëtare 2023, peshkatarët mbështeten përmes masës për rinovimin e infrastrukturës së anijeve të peshkimit, e cila ka për qëllim të nxisë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, përmes përmirësimit të kushtetve të punës dhe rritjen e prodhimit vendas.



peshkut. Prej vitit 1995, kompania

Financuar prej Skemës Kombëtare të Mbështetjes, "Mare

## Laboratori i kontrollit ushqimor në Durrës: Deda: I gjithë sistemi sipas standardeve të BE-së

Tashmë laboratorit Rajonal i Kontrollit Ushqimor në Durrës është tërësisht funksional, i gjithë sistemi është i ndërtuar sipas standardit evropian, pas rinovimit së fundmi, me mbështetjen e CHIHEAM Bari SAFIAL, financiar nga Agjencia italiane për Bashkëpunimin Zhvillimor (AICS).

Drejtoresha e AKU-së, Jeta Deda u shpreh se, "situata e sigurisë ushqimore në vend është në rritje dhe krahas investimeve në krijimin e kapaciteteve të tilla laboratorike bashkëkohore, po zhvillohen trajnime të inspektorëve për aplikimin e ekzaminimeve të kontrollit sipas modeleve të BE-së".

Deda tha se, me mbështetjen e projektit SAFIAL dhe nën drejtimin e ekspertëve të CIHEAM Bari, është zhvilluar pranë laboratorit të AKU Durrës, trajnimi mbi aplikimin e teknikave serologjike për zbu-

limin e patogjenëve të karantinës bakteriale dhe virale.

jeve bakteriale dhe virale. Falë këtyre bashkëpunimeve



Në këtë trajnim morën pjesë specialistët e laboratorit të AKU Durrës dhe specialistët të departamentit të shëndetit të bimëve pranë ISUV. U krye aplikimi DAS-TAS-ELISA, qasje të automatizuara dhe manuale për bimët e domates dhe ullirit për të vlerësuar praninë e sëmund-

specialistët e laboratorëve të AKU dhe ISUV kanë përmirësuar aftësitë e tyre në zbulimin e patogjenëve të bimëve të paraqitura në programet e certifikimit.

"Është bërë një hap i madh në konsolidimin e sigurisë ushqimore, si kusht dhe për integrimin e vendit në BE", tha Deda.

## Tri shtyllat kryesore në fokus të RisiAlbania-s, për punësimin e të rinjve

RisiAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga një konsorcium i përbërë nga HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Partners Shqipëria. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në rritjen e punësimit mundësi për të rinjtë dhe të rinjtë (15-29 vjeç) në Shqipëri. Ky synim do të arrihet nëpërmjet: (i) Rritjes së rritjes dhe krijimit të vendeve të punës nga sektori privat në tre nënsektorë të përzgjedhur (agrobiznes, turizëm dhe TIK), (ii) Shërbime të përmirësuara të orientimit në karrierë dhe ndërmjetësimit në punë, (iii) Përmirësimi dhe zhvillimi i aftësive të të rejave dhe të rinjve nëpërmjet privatëve të orientuar drejt tregut programet e trajnimit joformal të aftësive.

RisiAlbania ka hyrë aktualisht në fazën e tretë e cila pritet të zhvillohet në periudhën nëntor 2021 – tetor 2025. Nën shtyllën e dytë, përmirësimi i ndërmjetësimit në punë dhe shërbime që mundësojnë punësim të suksesshëm për punëkërkuarët e rinj, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësitë (NAES) mbetet një nga partnerët kryesorë të projektit. Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi është institucioni përgjegjës për zbatimin e punësimit politikat dhe masat, dhe përgjegjës për arsimin dhe aftësimin profesional. Risi mbështet AKSHP të rrisë performancën e shërbimeve të punësimit me fokus të veçantë në rritjen e bashkëpunimit me bizneset.

Në këtë këndvështrim, gjatë fazës së mëparshme, RisiAlbania mbështeti AKSHI-n duke zhvilluar metodologjinë e bashkëpunimit me bizneset, që përfshin ciklin e plotë të shërbimeve ndaj biznesit dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve të ILO-s për t'i shërbyer bizneseve dhe ndaj ofrojnë një shërbim të unifikuar në të gjitha ILO-t në të gjithë vendin.

Përveç kësaj, NAES ka pasur një prani në internet për punëdhënësit duke ofruar akses

në publikimin e vendeve të lira të punës, duke parë grupin e kandidatëve të regjistruar në portalin NAES, etj. Akoma ekziston nevoja për të forcuar komunikimin e AKSHM me punëdhënësit për të promovuar më mirë shërbimet e Zyrave të Punësimit për ta. Qëllimi është të tërheqë biznese më aktive për t'u përdorur shërbimet e zyrave të punësimit dhe për të mbështetur punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara.

### Drejt punëve më të mira në Shqipëri

A jeni i interesuar të mësoni se si projektet e Zhvillimit të Sistemit të Tregut mund të kontribuojnë në punësimin të denjë, duke përmirësuar cilësinë e punës brenda sektorëve dhe grupeve të veçanta?

Shikoni këtë artikull informues që shpaketon përvojën e RisiAlbania, një projekt i zbatuar nga Helvetas, në rritjen e rezultateve të punësimit për të rinjtë dhe të rejtat në sektorët e agrobiznesit, turizmit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe BPO. Artikulli shqyrton se si projekti RisiAlbania përshtati një qasje të ILO-s për të zhvilluar një kartë vlerësimi të cilësisë së punës dhe për të krahasuar aspektet e cilësisë së punës brenda dhe ndërmjet sektorëve të tyre të synuar.

Tradicionalisht, projektet e zhvillimit të sistemeve të tregut (MSD) janë fokusuar në rezultatet e krijimit të vendeve të punës. Megjithatë, ka një njohje në rritje se jo vetëm numri, por edhe 'cilësia' e këtyre vendeve të punës ka rëndësi për një rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Megjithatë, matja e një teme kaq shumë dimensionale sa 'cilësia e punës' mund të shkaktojë sfida konceptuale dhe praktike për programet e MSD. Projektet MSD, në fakt, zakonisht matin cilësinë e punës në nivelin e një pune ose firme individuale, në krahasim me treguesit statistikore të punës së denjë të ILO-s që matin cilësinë e punës në nivelin makro të ekonomisë më të gjerë dhe

sistemeve të tregut të punës.

Identifikimi i dimensioneve përkatëse të cilësisë së punës për të rinjtë ose aktualisht të punësuar, ose me potencial për të qenë i punësuar, në profesione brenda agrobiznesit sektorët e turizmit dhe TIK-ut, (Diagnostifikim i Cilësisë së Punës) u krye në bashkëpunim dhe në konsultim me partnerët kombëtarë.

Qëllimi i studimit ishte të fitonte njohuri në rrugën drejt mbështetjes dhe matjes për punë të denjë në Shqipëri dhe të ofronte udhëzime praktike për zonat e ndërhyrjes në të ardhmen. Diagnostifikimi përshtati qasjen e ILO-s ndaj zinxhirit të vlerës.

### Procesi i mbledhjes së të dhënave

RisiAlbania identifikoi një sërë treguesish që janë nën pesë aspekte kuptimplote të cilësisë së punës: të ardhurat, barazia, punësimi, mjedisi i punës dhe pritshmëritë e punës.

Më pas u mblodhën të dhëna për këta tregues nga korriku deri në gusht 2022, përmes tri, metodave kryesore: anketa e ndërmarrjeve, intervistat e informatorëve kryesorë dhe diskutimet në fokus-grupe.

Një anketë e sipërmarrjeve u zhvillua në korrik 2022. 102 biznese u përgjigjën, të cilat së bashku punësojnë pothuajse 3000 punëtorë. Intervistat ballë për ballë janë kryer me biznese aktive në të tre sektorët.

Mbi 50 intervista me informatorë kryesorë me fokus aktorë të tregut. U zhvilluan diskutime në grup me pothuajse 90 të rinj.

### Agrobiznes

Brenda sektorit të agrobiznesit, bimët medicinale dhe aromatike (MAP) shënojnë rezultate relativisht të mira në treguesit e barazisë, por janë më keq sa i përket të ardhurave dhe mjedisit të punës. Nënsektori i perimeve gjithashtu ka rezultate relativisht të mira për treguesit e barazisë, por më keq për perspektivat për të mësuar dhe avancim në karrierë.

## Mbështetja nga Skema Kombëtare, Endriti nga Lushnja parashikon 45-50 kv grurë për hektar

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural solli shembullin e Endrit Koçiajt, një nga përfutuesit e masës mbi kultivimin e grurit nga Skema Kombëtare 2022.

Në fshatin Grabian të Lushnjës, fermeri mbolli vitin e shkuar një sipërfaqe prej 82 hektarësh me grurë, ku parashikon një prodhim prej 45-50 kv grurë për ha.

Endriti ka rreth 10 vite që merret me bujqësi, ku lidhja e tij me tokën ka nisur me kultivimin e luleshtrydheve, por edhe në

sajë të mbështetjes së dhënë nga skemat subvencionuese është motivuar në zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit bujqësor.

Masa e mbështetjes së grurit ishte një risi në Skemën Kom-

bëtare 2022, e cila dha ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e sipërfaqeve të mbjella, me qëllim plotësimin e nevojave vendase dhe shmangien e importit.





## AKTUALITET

## Pikë e re grumbullimi në Kosmaç, Krifca: Zgjidhje nevojës së kahershme të fermerëve

Politikat mbështetëse për prodhimin bujqësor dhe ngritjen e pikave të grumbullimit, po fuqizojnë zinxhirin e vlerës dhe kanë ulur raportin e eksport-imperteve në nivelin 1 me 3.

Ministrja e Bujqësisë dhe

Bashkinë e Vaut të Dejës i jep zgjidhje një nevojë të kahershme të fermerëve të zonës të cilët prodhojnë rreth 3000-4000 tonë perime në vit, por deri më sot nuk kishin një pikë grumbullimi me standarde dhe tregtonin direkt nga serrat”, u

bujqësore, e ndërtuar sipas standardeve më të mira, garanton ruajtjen e fruta-perimeve me standardet e duhura dhe në kushte optimale cilësie, teksa furnizon tregun me produkte të freskëta në çdo stinë.

Ministrja tha se, financimi në pika grumbullimi realisht është rrjetëzuar në të gjithë gamën e mbi 450 mijë fermerëve në Shqipëri.

“Puna që kemi bërë dhe vijojmë me investimet në pikat e grumbullimit është transformuese sepse ka krijuar një platformë të re për bujqësinë dhe i ka dhënë lehtësi të madhe fermerëve që prodhojnë dhe mbledhen te pikat e grumbullimit dhe e kanë shumë më të lehtë për shitjen e produkteve”, tha Krifca.

Me mbështetjen nga AZHB janë rreth 140 pika grumbullimi fruta-perime. Ndërsa janë kontraktuar 38 subjekte vetëm përmes IPARD, me rreth 39 milionë euro investime që po shkojnë vetëm për pikat e grumbullimit dhe shtimin e kapaciteteve ruajtëse frigoriferike e përpunuese për produktet bujqësore.



Zhvillimit Rural inspektoi pikën e re të grumbullimit në Kosmaç, të Vaut të Dejës, një investim i ngritur me mbështetjen e AZHBR.

“Më vjen mirë që me pikën e re të grumbullimit në Kosmaç, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me

shpreh Krifca.

Ministrja tha se, ky investim përveçse plotëson nevojën imediate për grumbullim, ruajtje e seleksionim, ul dhe kostot për të gjithë zinxhirin deri tek konsumatori final.

Qendra e re e grumbullimit dhe magazinimit të prodhimeve

## Ibrahimaj: Shkolla profesionale “Rakip Kryeziu”, më shumë mundësi për të rinjtë

Riparimi i kampusit të shkollës profesionale “Rakip Kryeziu” e cila ofron aftësimin e profile, si ai bujqësor, veterinar, shërbime sociale shëndetësore e teknologji ka përfunduar.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj pa nga afër mjediset të rinovuar të kampusit të shkollës.

Ibrahimaj bëri të ditur se kjo shkollë me infrastrukturë moderne e kurrikula të përmirësuara ka mundësi që të akomodojë shumë herë më shumë të rinj dhe t’i shërbejë rajonit dhe më gjerë.

“Jo vetëm me mbështetjen buxhetore, por edhe falë partnerëve tanë ne po zhvillojmë sistemin dual profesional që t’i përgjigjemi kërkesave që ka



tregu i punës”, tha ajo.

Gjithnjë e më shumë nxënësit po zgjedhin shkollat profesionale, për të gjetur veten shpejt në tregun e punës. Rreth

18 279 të rinj kanë zgjedhur të studiojnë në arsimin e mesëm profesional në 23 drejtime mësimore, në 35 shkolla profesionale në të gjithë Shqipërinë.

## Mbështetja nga AZHBR, bletaria rriti me 64% numrin e zgjojeve

Bletaria është një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë, e cila ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm në vitet e fundit.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) prej vitit 2009 ka mbështetur vazhdimisht këtë sektor përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes, por edhe programit IPARD.

Sot numërojmë rreth 400,000 zgjoje bletësh në të gjithë vendin, ku vetëm në 10 vitet e fundit numri i zgjojeve është rritur me 64%, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e prodhimit.

Në vitin 2022, në sajë të Skemës Kombëtare të Mbështetjes, u financuan 2681 bletarë, ndërsa përmes programit IPARD është investuar në linja përpunimi, ambalazhimi, si edhe magazina për ruajtjen e produkteve, duke synuar përveç tregut vendas, edhe atë të jashtëm.

Autoritetet e linjës shprehin bindjen se mbështetja e këtij sektori përtej efektit pozitiv që ka në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës ekonomike të tij, ka një efekt më të rëndësishëm dhe strat-

egjik në performancën ekonomike të të gjithë sektorit bujqësor në vend.



## Dita Botërore e Bletëve, MBZHR: Mbështetje për rreth 2 681 bletarë në vitin 2022

Në Ditën Ndërkombëtare të Bletëve, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca bëri të ditur se, qeveria ka mbështetur financiarisht këtë sektor përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes, ku vetëm në vitin 2022 janë mbështetur rreth 2 681 bletarë në të gjithë vendin.

Dhe këtë vit, theksoi Krifca, kanë aplikuar 3 899 për të përfutur mbështetje.

“Ju keni një fuqi dhe vlerë të jashtëzakonshme për konsumatorët, mjedisin dhe ekosistemin bujqësor dhe ekonomik të vendit. Ndaj dhe jeni vendosur në prioritetet e politikave në bujqësi, për t’ju mbështetur dhe fuqizuar edhe më tepër, për të promovuar bletarinë cilësore, instrumentat e skemave të cilësisë, emërtimet e origjinës, treguesit gjeografik, specialitetet tradicionale të garantuara dhe standardet e etiketimit duke i rritur kështu vlerën tregtare të prodhimeve të bletës”, shprehet ministrja Krifca, në një mesazh drejtuar bletarëve.

Krifca vuri në dukje se, para pak muajsh qeveria miratoi ligjin organik të bletarisë, shumë të rëndësishëm dhe të kërkuar prej kohësh nga mbrojtësit e bletës dhe prodhuesit e mjaltit në vendin tonë.

Një ligj, theksoi Krifca, “i ndërtuar në bashkëpunim të plotë me të gjitha shoqatat e bletarëve, në përputhje me praktikant më të mira të BE-së, për t’iu përgjigjur problematikave tuaja”.

“Ligji vendosi themelin dhe kuadrin e plotë për bletarinë në mjedis, bujqësi, ekonomi dhe krijimin e të ardhurave, duke rregulluar në mënyrë të plotë dhe shteruese të gjithë dinamikat e bletarisë në lidhje me marrëdhëniet me shërbimin veterinar dhe pushtetin vendor, territorin, shtegëtimet e kontrolluara dhe sigurinë e produkteve të bletës, por edhe mbrojtjen e zhvillimin në territor të një specieje të tillë jetike për polenizimin e kryqëzuar dhe biodiversitetin, pra për vijimësinë e jetës”, shtoi Krifca.

Përveç rregullimit të sektorit, mbrojtjes së bletës, mbështetjes së drejtpërdrejtë të bletarëve, Krifca shtoi se, “po mbështen edhe punuesit e nënprodukteve dhe startup-et që duan të ofrojnë produkte të diversifikuara të shërbimeve kurative, apikulturës, apo apiturizmit, në hapësirën rurale të magjishme shqiptare që mund ta mundësojë zhvillimin e kësaj nyjeje të rëndësishme ekonomike”.

“Ne jemi të bindur se mbështetja e këtij sektori, përtej efektit pozitiv që ka në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës ekonomike, ka një efekt më të rëndësishëm dhe strategjik në performancën ekonomike të gjithë sektorit bujqësor të vendit”, u shpreh ajo.

Ministrja solli si shembull pozitiv regjistrimin e produkteve si specialitet tradicional i garantuar STG për ta çuar në një nivel tjetër promovimin dhe mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve kudo në botë.

## IPARD III, Krifca: Financim prodhuesve të verës

Programi IPARD III, me 9 masa të akredituara për mbështetjen e bujqësisë shqiptare, me një buxhet të shtuar prej 146 milionë euro, adreson për herë të parë financim për prodhuesit e verës në tri masa mbështetje.

Lajmin e mirë e dha ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, në takim që zhvilloi me prodhuesit e industrisë së verës shqiptare, të cilët i informoi se, ata përfitojnë mbështetje nga IPARD III nga Masa 1, për ndërtimin e vreshtave, Masa 3, për ndërtimin e kantinave dhe Masa e qasjes LEADER, ku sipërmarrjet do të mbështeten për investime në teknologji bashkëkohore dhe asistencë teknike.

“E kemi nisur këtë faqe të re duke mundësuar investime në asete fizike që kanë rritur ndjeshëm parametrat e cilësisë dhe infrastrukturën e vreshtave dhe kantinave, pasuar nga dedikimi për të ndërtuar me efektivitet dhe në bashkëpunim të plotë me kantinat një kuadër të ri ligjor për verën që mbron prodhuesit vendor, formalizon sektorin dhe ruan pasurinë e varieteteve autoktone”, u shpreh ministrja.

Krifca renditi një sërë angazhimesh konkrete në mbështetje të këtij sektori, ndër të cilat, siç tha ajo, “përpjekjet masive për të promovuar ndërkombëtarisht e me çdo mjet prodhuesit dhe etiketat tona, si një eksklensë shqiptare duke synuar rritjen e konsumit të etiketave shqiptare në vendin tonë dhe rritjen e eksporteve të verës”.

“Prodhimi i verës Made in

Albania për vitin 2022 arriti në rreth 30.000 hektolitra, ose 15% më shumë se viti i kaluar. Teksa 67 njësi prodhuese të kantinave, janë certifikuar e regjistruar, vitin e fundit, nga të cilat 20 në Durrës, 13 në Tiranë, 10 në Berat dhe 8 në Shkodër.

dhimit shqiptar dhe synojmë të nxisim këtë industri drejt teknologjive të përparuara për ta bërë konkurruese në tregjet e huaja”, theksoi ministrja.

Pjesëmarrësit në këtë takim, u shprehën optimistë për bashkëpunimin me MBZHR, teksa treguan se tashmë e kon-



Eksporti i rrushtit është rritur me 22%, në vlerën e 48 milionë lekëve gjatë vitit 2022, krahasuar me një vit më parë, ndërsa është rritur marketimi i produktit shqiptar”, tha Krifca.

Duke u ndalur në epërsinë e strategjisë së MBZHR për mbështetjen e industrisë së prodhimit të verës, ministrja tha se sot, prodhuesit shqiptarë po zgjerojnë pjesëmarrjen në Panairin ndërkombëtar duke u faktorizuar në këto evente elitare me çmime nga profesionistët ndërkombëtarë të fushës.

“Kemi nisur një aksion për regjistrimin e Shqipërisë në OJV si një hap i rëndësishëm i aderimit të Shqipërisë në këto institucione ndërkombëtare, që i japin vlerë të shtuar pro-

siderojnë investimin në industrinë e prodhimit të verës më të lehtë, krahasuar me dhjetë apo pesëmbëdhjetë vite më parë.

“Mbështetja me grante nga programi IPARD i ka dhënë nxitje investimeve për prodhimin e verës në Shqipëri sipas standardeve më të mira. Sot vera shqiptare ka marrë jehonë në tregjet e huaja. Sot jemi më të fortë në teknologji, në cilësi produkti, që na bën dhe më konkurrues në treg”, thanë ata.

Përfaqësuesi i shoqatës e cilësoi Ministrinë e Bujqësisë një partnere në mbrojtjen e prodhimit vendas dhe zhvillimin e sektorit. “Hartimi i ligjit të ri për verën dhe vreshtarinë, është një mbështetje që vjen në kohën e duhur për industrinë tonë”, tha ai.



## FINANÇIM

# Financimi i Bizneseve të vogla dhe të mesme - USAID lançon platformën LORES, një zgjidhje Fintech për financimin e bizneseve në Ballkan

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në bashkëpunim me Creative Business Solutions (CBS), një firmë konsulence biznesi, ka filluar një zgjidhje rajonale FinTech të quajtur LORES+.

cialit të tij për t'i shërbyer të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Duke fuqizuar NVM-të, LORES+ do të mbështesë Shqipërinë në rrugën e saj drejt integritimit në Bashkimin Europian. Platforma do të nxisë rritjen

LYZE Engines of Growth”.

Gjatë aktivitetit të lançimit, Z. Enio Jaco, themelues i CBS dhe president i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, prezantoi platformën e re dhe veçoritë e saj, duke theksuar se nga LORES+ do të pëfitojnë SME-të dhe institucionet financiare.

“Do t'u mundësojë NVM-ve të kenë qasje në kapital në një mënyrë më efektive, me procedura aplikimi që zgjasin më pak se 90 sekonda, mbështetje falas të këshilltarëve tanë personalë LORES dhe norma më të larta të miratimit të kredisë (90%). Nga LORES+ do të përfitojnë gjithashtu bankat dhe institucionet e tjera financiare duke tërhequr klientë të rinj të verifikuar me një normë rreziku jashtëzakonisht të ulët (1% NPL). Për më tepër, LORES+ do të ofrojë përmbajtje arsimore falas për të përmirësuar njohuritë financiare të NVM-ve dhe do t'i udhëzojë ato në zgjedhjen e produkteve financiare më të përshtatshme nga ato të disponueshme në tregjet lokale, me fokus në produkte të veçanta ose të reja si financimi me fatura, dhe biznese në pronësi të grave ose të menaxhuara nga gratë”, tha Jaco.

LORES+ është një projekt rajonal që tani po fillon në Shqipëri dhe më vonë do të zgjerohet në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Synimi është të mundësojë aplikime për kredi që do të arrijnë një shumë minimale rreth 12 milionë dollarësh, duke përfutur 285 NVM gjatë 2.5 viteve të ardhshme.

ekonomike dhe inovacionin, duke çuar në një ekonomi më konkurruese dhe të pasur.

Duke folur në lancimin e LORES+, Z. Demian Smith, Zëvendës Shefi i Misionit në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, tha:

“Bizneset e vogla luajnë një rol kritik në nxitjen e rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Në Shqipëri, këto grupe përfaqësojnë mbi 95% të bizneseve dhe punësojnë mbi 80% të fuqisë punëtore. Megjithatë, ata marrin vetëm një të katërtën e financimit total nga institucionet financiare. Për të përmirësuar qasjen e bizneseve të vogla në financa, Qeveria e SHBA-së mbështeti zhvillimin e platformës LORES+ nëpërmjet aktivitetit tonë rajonalë USAID CATA-



Kjo platformë e re do t'u mundësojë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) të aplikojnë për kredi online dhe të kenë akses në informacione mbi mundësitë financiare të disponueshme për të rritur bizneset e tyre, duke u kursyer atyre kohë dhe përpjekje.

LORES+ është një mjet dhe iniciativa më e fundit e mbështetur nga USAID për të nxitur NVM-të në Shqipëri dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Si një zgjidhje dixhitale, LORES+ bazohet në suksesin e LORES 1.0, i cili gjithashtu u zhvillua me mbështetjen e USAID-it përmes projektit të mëparshëm SmartCapital. LORES+ pritet të ketë një ndikim më të madh, veçanërisht për shkak të poten-

## Rama: Taskforcë për të regjistruar pronat në kohë rekord, aty ku banorët janë marrë vesh

Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me sipërmarrës të Malësisë së Madhe deklaroi se do të ngrihet një taskforcë për të regjistruar në mënyrë të përspejtuar pronat.

“Tani sipërmarrja kërkon vetëm mbështetje, dhe mbështetja më e madhe është zbatimi i ligjit “2020” që është bërë së bashku me Paulin Sterkajn posaçërisht për Malësinë e Madhe. Ka shumë banorë që nuk e pranojnë “7501”, por ndërkohë janë marrë vesh me njëri-tjetrin për pronat. Nëse janë marrë vesh me njëri-tjetrin për pronën, atëherë nuk ka më problem për tu regjistruar. Por edhe këtu duhet të shtyjmë më fort. Do të ngrejme një taskforcë të veçantë për të regjistruar në kohë rekord pronat që janë në dosje gati, ku njerëzit janë marrë vesh me njëri-tjetrin”, tha Rama.

Kjo sipas tij, do të nxisë investime të tjera.

zona, në Gruemirë për shembull, që kanë sherr me njëri-tjetrin po



aty ku s'kanë sherr dhe janë të gjithë dakord, tek Buni i bajraktarit poshtë aty, të gjithë bien dakord. 60 e ca familje, s'kanë ato probleme. Atëherë ta zgjidhim”.

“Në Reç kemi gati të gjithën, do ta zgjidhim dhe kjo ka marrë kohë, por duan kohë gjërat, nuk bëhen sepse do ti të bëhen sot, por duan kohën e vetë, por

kjo do të nxisë investime të tjera, se është gjynah. E kanë

tokën, s'kanë probleme me komshinjtë e të aplikojnë për të marrë mbështetjen tonë. Ja dhe për fazën tjetër të projektit këtu ka nevojë për një regjistrim të tokës. Është blerë toka me të gjitha, me kontratë e me të gjitha, pronarët janë në rregull, por duhet regjistruar, por s'janë vetëm këto”, u shpreh Rama.



## Përmirësimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë në agrobiznes, starton më 7 Qershor në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë, projekti i mbështetur nga Zvicra

*Projekti më i ri për agrobiznesin, mbështetje në sektorët e vajit të ullirit, bimëve mjekësore dhe perimeve të freskëta*

Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë - ITC me qendër në Gjenevë (një agjenci e përbashkët e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Kombeve të Bashkuara) dhe Konfederata Zvicerane që vepron përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) kanë nënshkruar pak kohe me pare një projekt prej 5 milionë CHF për të promovuar tregtinë në Shqipëri, (përfshirë Serbinë, Tashikistanin dhe Uzbekistanin), me fokus në agrobiznes.

Ndikimi afatgjatë i parashikuar i projektit është të kontribuojë në rritjen e rritjes gjithëpërfshirëse të eksportit në zinxhirët e vlerave të synuara, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës dhe punësimeve të denjë (punë me shumë dhe më të mira).

Projekti do të fokusohet në konkurrencën dhe rritjen e qëndrueshmërisë të eksportit të NVM-ve (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) dhe përmirësimin e kapaciteteve të organizatave mbështetëse të biznesit (BSO) për të ofruar shërbime cilësore për NVM-të. Për më tepër, programi do të nxisë shkëmbimin rajonal dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet SME-ve dhe BSO-ve nga vendet partnere.

Agrobiznesi u identifikua si një sektor prioritar i zbatueshëm për asistencë në të katër vendet, pasi ofron potencial të rëndësishëm për përfshirjen sociale të grupeve vulnerabel dhe luan një rol të veçantë në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Ndërkohë që sektorët apo produktet që do të ndihmohen janë:

- Vaji i ullirit

- Bimët mjekësore dhe aromatike

- Perimet e freskëta (domate, kastravec)

Përtë demonstruar ndryshime të prekshme që çojnë në rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, projekti do të fokusohet në grupet e produkteve të përzgjedhura në çdo vend.

Projekti është i strukturuar rreth tre rezultateve të formuluara si më poshtë:

Rezultati 1: Përmirësimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së NVM-ve në sektorin e agrobiznesit (sektorët e përmendur më lartë)

Rezultati 2: Përmirësimi i performancës së organizatave ne mbështetje të biznesit (BSO) në sektorin e agrobiznesit

Rezultati 3: Shkëmbimi rajonal/sektorial dhe shkëmbimi i njohurive dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sektorit

Projekti ka filluar me një fazë fillestare 6-mujore për të siguruar që asistencë teknike t'i përgjigjet nevojave dhe prioritetëve të vendeve përfutuese, të krijuar zyrtarë e projektit dhe të përzgjidhen grupet e produkteve përfundimtare për fokusin e projektit në secilin vend.

Projekti do të ndihmojë SME-të në prodhimin e mallrave sipas kërkesave të tregut, duke i lidhur ato me tregjet e synuara për të rritur shitjet, duke mbështetur transformimin e tyre dixhital dhe respektimin e parimeve/standardeve të qëndrueshmërisë. Për këtë qëllim, përfutuesit duke përfshirë qeverinë dhe institucionet përkatëse sektoriale do të



mbështeten në marrjen e një qasjeje strategjike ndaj zhvillimit të sektorit dhe BSO-të për të ofruar shërbim cilësor për NVM-të për fushat e përzgjedhura prioritare.

Nisja e projektit është caktuar për tu startuar në datë 7 Qershor 2023 në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me Ministrin Krifca, përfaqësuesit e SECO, përfaqësuesit e ITC nga Gjeneva dhe Menaxheri i projektit për Shqipërinë Genti Beqiri.

Fjalën e hapjes në këtë takim do ta mbajë Frida Krifca, ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas agjendës fjalën do ta marrin Patrik Meier, Zëvendës Shef i Misionit, në Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri dhe z. Ashish Shah, Drejtor i Divizionit të Programit ITC-së. Ndërsa diskutimet do të vijojnë dhe nga përfaqësuesit e agrobiznesit, Filip Gjoka, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Industrisë së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri, z. Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar.

Z. Armen Zargaryan, Koordinator i Programit ITC, Zyra për Evropën Lindore dhe Azia Qendrore dhe z. Genti Beqiri, Menaxher në Shqipëri i Programit Kombëtar ITC-së, do të flasin për prezantimin e aktivitetëve kryesorë të projektit, gjetjet, sfidat, faza fillestare si dhe për planin e punës për vitin 2023. Në fund takimi do të vijojë me diskutime të lira, pyetje dhe përgjigje për çështjet që paraqiten.

## Programi zvicerano-austriak për Zhvillimin Rajonal

(Vijon nga faja 2)

për zhvillimin rajonal brenda Fondit Shqiptar të Zhvillimit

• Kthimi në prioritet i zhvil-

limit rajonal - si reformë dhe si politikë

• Asistencë ndaj qeverisë shqiptare për negociatat me BE-në - Kapitulli 22 mbi Politikat

dhe Koordinimin Rajonal

• Zbatimi me sukses i skemave të granteve me përmirësime konkrete në disa rajone

## Autoriteti i Konkurrencës mbyll hetimin në tregun e vajit vegjetal

Autoriteti i Konkurrencës mbylli hetimet në tregun e importit, prodhimin dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

Përmes një njoftimi për shtyp, Autoriteti i Konkurrencës bën të ditur se, pas analizës së tregut u konstatua se, çmimet mesatare mujore të shitjes me shumicë nga kompanitë që operojnë në treg, nuk janë të përafërta.

“Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim raportin e hetimit të thelluar ndaj ndër-

marrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURREZ SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimin dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal. Në përfundim të analizës së çmimit të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, rezultoi se, gjatë periudhës hetimore, rritja

e çmimit të shitjes me shumicë e bërë prej ndërmarrjeve nën hetim ka reflektuar rritjen e çmimit mesatar të importit. Po ashtu, u konstatua se çmimet mesatare mujore të shitjes me shumicë nuk janë të përafërta për këto ndërmarrje”, thuhet në njoftimin e AK.

Pas kësaj, Komisioni i Konkurrencës, vendosi mbylljen e hetimit të thelluar ndaj

(Vijon në faqen 7)



## AGROTURIZËM

## Zhvillimi i agroturizmit, fuqi për rivitalizimin e fshatrave

“Shija e pyllit në tryezat tona” ishte tema e aktivitetit të organizuar nga Shoqata e Agroturizmit në Shqipëri me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Agroturizmit, të cilës iu bashkua edhe ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca.

Ministria, në fjalën e saj, u ndal në sfidat me të cilat përballlet ky sektor, si dhe ndikimin që ka agroturizmi në zhvillimin dhe rivitalizimin e zonave rurale.

“Tek Fustanella Farm, në Petrelë, folëm me të ata që udhëheqin sipërmarrje të mëdha e ata prodhues që synojnë të kthejnë shtëpitë e tyre në bujtina,

të cilët janë bërë pjesë e rrjetit fantastik të Shoqatës së Agroturizmit”, u shpreh Krifca.

“Folëm për sfida e sukseset si dhe për fuqinë e agroturizmit për të rivitalizuar fshatrat dhe

prodhimet tona autentike që po i jep një frymë të re zhvillimi zonave tona të thella rurale”, theksoi ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca.



## Ish-emigrantët bëhen fermerë, katër vëllezërit mbjellin bajame në Roskovec

Pas më shumë se dy dekadave emigrim në Greqi 4 vëllezë Bilbili, Demiri, Agroni dhe Durim Gega, janë kthyer në vendlindjen e tyre në Kurjan të Roskovecit duke investuar në mbjelljen e 42 dylmëve me bajame apo rreth 1000 pemë të kësaj kulture.

për një kulturë të re bujqësore. “Vendimi për të mbjellë një sipërfaqe prej 4,2 ha nuk ishte i thjeshtë por duke parë se ky frut importohet nga Greqia dhe kërkesat janë të shumta të tregut vendas, vendosëm që të merrnim fidanët në Greqi dhe të kemi sot këtë sipërfaqe me 1000 pemë

që ishte edhe prodhimi i parë morëm rreth 20 kuintal bajame ndërkohë që këtë vit pritjet një dyfishim i prodhimit”.

Katër vëllezërit Gega krahas kontributit të tyre në tokat e të parëve, kërkojnë edhe mbështetjen e shtetit për zhvillimin e sipërmarrjes së tyre.

“Ndiham nga shteti ka qenë subvencioni në karburant ndërkohë kemi aplikuar edhe për këtë vit. Problemi që po përballlemi është ujytja. Për shkak të rrethit kodrinor në plantacionin me bajame deri tani kemi marrë ujën me vështirësi. Kemi hapur një pus por kërkojmë shtrimin e linjës së energjisë elektrike që të instalojmë pompat”.

Por vëllezërit që kanë bashkuar të ardhurat në kultivimin e bajames i janë përkushtuar edhe kulturave të tjera, duke mbjellë rreth 6 ha sipërfaqe me grurë si dhe mbjelljen në 2 ha me frutin e shegës.



Kryesisht sipërfaqja më e madhe e kësaj zone është e njohur për ullishtet, ndaj 4 vëllezërit po lënë shenjë në fshat

bajame. Si çdo fillim ka qenë i vështirë por megjithatë sot jemi të kënaqur në prodhimin dhe shitjen në treg. Vitin që kaloi

## Mbështetje nga Skema Kombëtare, 27-vjeçari nga Kavaja shton hektarët e mbjellë me grurë

Olsian Meta është një nga përfituesit e masës mbi kultivimin e grurit nga Skema Kombëtare 2022.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në rubrikën “Njerëzit e Bujqësisë”, ndau sot në rrjetet sociale shembullin e Olsianit, të riut 27-vjeçar, që e konsideron bujqësinë, motivin kryesor që e ka kthyer nga emigrimi, për të punuar në tokën e tij.

Ai tregon se, mbështetja nga AZHBR është një arsye më shumë që i ka dhënë forcë për të punuar më shumë me bujqësi dhe për të zgjeruar aktivitetin e tij.

Olsiani së bashku me familjen e tij kanë 20 vite që merren me bujqësi dhe vitin e shkuar arritën të mbjellin një sipërfaqe prej 20 ha me grurë, në fshatin Luz i Vogël të Kavajës.

Këtë vit Olsiani parashikon të përfitojë 120 tonë grurë, për të cilën ka një marrëveshje shitjeje më një prej fabrikave

për prodhimin e miellit dhe drithërave, por edhe traktori i përfituar nga programi IPARD II, e ka ndihmuar në lehtësimin e punës për shtimin e sipërfaqes së mbjellë.

Skema e grurit 2022 ndikoi

në dhe ka rritur fondet për subvencionimin e drejtpërdrejtë të fermerëve në të gjithë sektorët rural dhe në çdo skaj të vendit, me qëllim lehtësimin e kostove të prodhimit dhe mbështetjen e ekonomisë fermerë.



ndjeshëm në uljen e kostove duke synuar rritjen e prodhimit dhe të ardhurat për fermerët. Nga kjo skemë përfituan 3960 fermerë, për një sipërfaqe të mbjellë prej 15050 ha.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka zgjeruar masat mbështetjes për bujqësi-

Skema kombëtare e mbështetjes në Bujqësisë 2023, shënoi një rekord aplikimesh nga fermerët për të 9 masat mbështetëse, duke konfirmuar edhe një herë rritjen e besimit të fermerëve tek mbështetja me financime dhe rritja e sipërmarrjeve bujqësore në ekonominë rurale.

## Pikat e grumbullimit, domosdoshmëri për lehtësimin e fermerëve

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po e mbështet rritjen e prodhimit bujqësor paralelisht edhe me shtimin e pikave të grumbullimit dhe agropëpunimit sipas standardeve më të mira, që i shtojnë vlerë produktit deri tek konsumatori final.

që mbështesin uljen e kostove të prodhimit, rritjen e prodhimit bujqësor vendas dhe ngritjen e pikave të grumbullimit dhe agropëpunimit”.

“Investimet për krijimin e pikave të grumbullimit, hapësirat magazinuese dhe dhomat frigoriferike në ferma janë një

e numrit të pikave të grumbullimit ka një ndikim të rëndësishëm në shtimin e eksporteve të produkteve bujqësore, duke iu përgjigjur më së miri kërkesave për cilësi dhe siguri edhe në tregun e jashtëm.

Krifca dha statistika dhe fakte për investimet e prekshe në këtë sektor që kanë lehtësuar aksesin e fermerëve në tregje me vlerë të shtuar.

Në sajë të programit IPARD II, në vendin tonë janë realizuar 76 investime për rritjen e kapaciteteve ruajtëse të produkteve bujqësore dhe blegtorale në ferma, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së prodhimit.

Deri tani, vlera e grantit për këto sipërmarrje ka arritur në 24 milionë euro fonde nga Bashkimi Evropian në bashkëfinancim me qeverinë shqiptare.

Ndërkohë, IPARD III do të shtojë masën e mbështetjes për investime të reja në qendra grumbullimi, përpunimi dhe paketimi të prodhimeve bujqësore.



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se, “Skema Kombëtare e Mbështetjes, programi IPARD, janë pikërisht instrumenti i duhur

domosdoshmëri për lehtësimin e punës së fermerëve dhe krijimin e kushteve të duhura për ruajtjen e produkteve”, u shpreh Krifca.

Ministria vlerësoi se, rritja

## Agjencia e Trajtimit të Pronave rivlerëson 4 mijë vendime - Raporti, në Kuvend: Asnjë kompensim nën nivelin 10% të vlerës reale të tokës

Agjencia e Trajtimit të Pronave bën me dije se ka rishikuar mbi 4 mijë vendime kompensimi të pronarëve, të cilat kanë rritur ndjeshëm faturën që duhet të paguajë shteti për këtë qëllim. Sipas raportit të veprimtarisë të sapodopozuar në Kuvend, Agjencia shpjegon se shkak është bërë miratimi I ndryshimeve në ligjin e pronës të miratuar nga Kuvendi në fund të vitit të shkuar, sipas të cilave asnjë dosje prone nuk mund të kompensohet nën 10% të vlerës reale të tregut. Ndryshimet u diktuan nga një vendim I vitit 2021 të Gjykatës Kushtetuese, e cila pezulloi Ligjin e pronave të vitit 2015 në mënyrë që ai të përcaktohen këtë dysheme kompensimi.

ATP bën me dije se gjatë periudhës së hartimit të ndryshimeve të ligjit, Sektori i saj i Kompensimit vijoi punën në zbatim të pikës 16/4 të VKM nr. 223/2016 e ndryshuar me VKM nr. 1114/2020, e cila u miratua si rekomandim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen

Beshiri kundër Shqipërisë, duke kryer përlllogaritjen e vendimeve që kanë njohur të drejtën e Kompensimit, bazuar me vlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual. Sipas një analize paraprake të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, rezultojnë që preken rreth 4672 vendime dhe do të përfitojnë një vlerë financiare afërsisht 18,5 miliardë lekë, apo afërsisht 180 milionë dollarë.



Fatura për kompensimin financiar të pronarëve është llogaritur nga Qeveria në rreth 1 miliardë

nisur edhe këtë vit, edhe pas miratimit nga Kuvendi të ndryshimeve ligjore në fund të vitit 2022. Vetë ATP bën me dije se pengesë janë miratimi I akteve nënligjore.

## Autoriteti i Konkurrencës mbyll hetimin në tregun e vajit vegjetal

(Vijon nga faqja 6)

këtyre ndërmarrjeve.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës shqyrtoi dhe raportin mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.

“Nga analiza e çmimeve

mesatare mujore të shitjeve me shumicë të produktit beton, në qarkun e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit vërehet se çmimet e aplikuar nga ndërmarrjet janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të

tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bën të ditur AK.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të betonit në qarkun e Tiranës





### SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

### KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

# Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**



## HISTORI SUKSESI

# Pajisje të teknologjisë së lartë me mbështetjen e IPARD, Krifca: Modeli i fermës ku po orientohet blegtorja

Me mbështetjen e programit IPARDII, sipërmarrjet po orientohen të investojnë në krijimin e fermave bujqësore dhe blegtorale sipas modeleve më të mira konkurruese të tregut me cikël të mbyllur duke ofruar standarde dhe vlerë të shtuar.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca vizitoi fermën "Fshatçe", në Libofshë të Fierit, një investim model drejt të cilit po orientohet blegtorja.

"Me Gentianin në fermën "Fshatçe", me mbi 900 krerë, një model i arrirë i fermave me cikël të mbyllur", tha Krifca.

Ministria e vlerësoi investimin në teknologjinë e përpunimit të ngjashëm me fermat më moderne në botë. Këtu tha ajo, standardet e teknologjisë së lartë zbatohen që nga mirëqenia e kafshëve, sigurimi i bazës ushqimore për to, prodhimi dhe deri tek produkti final.

Ministria Krifca shoqëruar edhe nga drejtoresha e AKU-së Jeta Deda inspektoi nga afër këtë sipërmarrje që i ka dhënë një tjetër shembull zhvillimit sektorit të blegtorisë.

Gentiani tregoi se, token e marrë me qira e ka kthyer në tokë pjellore ku kultivon bimë foragjere që janë bazë ushqimore për blegtorinë që mbarëshkon në fermën e tij.

Konkursi i Bizneseve të Gjëlbertha është një aktivitet që Partnerët Shqipëri organizon prej vitit 2012, i cili synon të stimulojë e inkurajojë inovacionin për ide biznesi të gjëlbertha në nivel lokal dhe të humtojnë rolin e filantropisë në angazhimin e komuniteteve lokale për të gjeneruar ide biznesi të bazuara në shfrytëz-

Përveç kësaj ai ka ngritur dhe ambientet për bluarjen e koncentrateve. "Mulliri dhe mishelatori janë pajisje të teknologjisë së lartë që i kam marrë me mbështetjen e programit IPARD", tha ai.

"Po bëjmë një plan për të aplikuar në thirrjen e tjetër të IPARD për një kombinat silose që na lehtëson shumë në procesin



bar të thatë", vuri në dukje ai. Kjo sipërmarrje është e përqendruar tek prodhimi dhe paketimi i qumështit. Këtu prodhohet qumështi i pasterizuar dhe të gjitha nënproduktet kryesore nga djathi, kosi, gjalpi etj., sipas standardeve më të mira. Drejtoresha e AKU-së Deda tha se, të gjitha produktet nga kjo fabrikë tregtohen me etiketë

bar të thatë", vuri në dukje ai.

Kjo sipërmarrje është e përqendruar tek prodhimi dhe paketimi i qumështit. Këtu prodhohet qumështi i pasterizuar dhe të gjitha nënproduktet kryesore nga djathi, kosi, gjalpi etj., sipas standardeve më të mira.

Drejtoresha e AKU-së Deda tha se, të gjitha produktet nga kjo fabrikë tregtohen me etiketë

magazinimit të ushqimit për blegtorinë në silose që kryejnë ushqyerjen e lopëve në racione sipas masës që duhet. Pra investimi në silose kryen ushqyerjen e blegtorisë në mënyrë automatike dhe hapësira që na krijohet në këtë qendër na shërben ta mbushim me jonxhë e

të unifikuar, të certifikuar nga AKU, ndërkohë që kryhen rregullisht të gjitha analizat.

Ministria Krifca e vlerësoi këtë investim si modelin më të mirë, shembull për fermat blegtorale ku synohet të arrijë ky sektor.

# Mozaik i jetës rurale - Historia e Ledinës nga Elbasani

Ledina është 47 vjeç, nga fshati Kuqan, në Elbasan. Më shumë se gjysmën e jetës së saj ia ka dedikuar kultivimit të produkteve në sera, ku çdo ditë punon së bashku me bashkëshortin.

Megjithëse puna në serat e prodhimit është e lodhshme dhe shpesh herë demotivuese kur produkti nuk shitet apo zhvlerësohet në treg, Ledina nuk ndahet kurrë nga puna e saj. Ajo thotë se kjo është puna që e mban me shpresë dhe se "nuk ka kënaqësi më të madhe kur hyn në serë dhe sheh bimët të rriten të shëndetshme e të bukura".

Lodhja e Ledinës nuk mbaron me serën, pasdite ajo shkon në ullishte dhe në pjesën tjetër të kohës kujdeset për familjen dhe qenushin e saj Aksa. Por prap thotë se "po të duash e gjen kohën e lirë". Prej kohësh i është bashkuar Grupit të Grave në Shirgjan në takime dhe shkëmbime eksperiencash me gra të tjera në sektorin agroushqimor ku ndajnë informacion, diskutojnë problematikat dhe vështirësitë që hasin.

"Nevoja jonë e vetme është grumbullimi, nevoja për të shitur produktin. Puna në serë është e lodhshme dhe të priten krahët kur sheh që të zhvlerëso-

het në treg apo kur nuk shitet.

Ashtu si edhe në zona të tjera rurale, mungesa e një pike grumbullimi vështëron punën e grav fermere. Megjithatë, ta

mëngjes".

Ky album fotografik synon t'i japë lexuesit një vështrim të Shqipërisë rurale, ku gratë marrin shumë role. Përm



kimet dhe bisedat e ndryshme me shoqet, organizatat dhe institucionet, e mbajnë Ledinën optimiste dhe e inkurajojnë për të vazhduar punën e saj me të njëjtin pasion dhe vendosmëri.

Me një buzëqeshje në fytyrë dhe me një shpirt optimist, Ledina thotë se "Nuk e kemi menduar kurrë ta lëmë fshatin. Lodhesh pak më tepër, por këtu më pëlqen çdo gjë, duke filluar që nga ushqimet bio, tek natyra dhe ajri i pastër që merr kur ngrihesh në

ban histori të ndryshme të grave dhe vajzave nga zonat e Pukës, Elbasanit dhe Kolonjës, me fokus tek sfidat e jetës së tyre të përditshme, familja, puna dhe koha e lirë. Realizuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në rolin e nën-kontraktorit në kuadër të projektit "Fuqizimi i Grave në Zonat Rurale dhe Turizmi" i cili po zbatohet së bashku me UN Women Albania, të financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

# Ja cilat janë start up-et fituese të "Konkursi i Bizneseve të Gjëlbertha 2023"

Partnerët Shqipëri organizoi së fundi "Konkursin e Bizneseve të Gjëlbertha 2023"

Bank, dhe Credins Bank.

Konkursi mbështet ide bi-



imin e burimeve lokale, ringjalljen e traditave të prodhimit dhe tregjeve lokale, duke pasur një qasje m iqësore ndaj mjedisit. Përmes mbështetjes së nismave inovatore që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal, Konkursi synon të kontribuojë në mënyrë thelbësore në ndërtimin e një rajoni të begatë, konkurrues dhe të paqetë të Ballkanit, në linjë me 7 objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Axhendës 2030.

Këtë vit, Konkursi u mundësua falë kontributit të Fondit Rockefeller Brothers, Tirana

znesi në dy fasha kryesore, sipas maturimit të idesë:

Fasha 1: Ide biznesi në fazë konceptuale

Fasha 2: Biznes në fazat e para të zhvillimit

Njëzetën finalistë të për zgjedhur mes konkurrentëve nga procesi i aplikimit, prezantuan idetë e tyre të cilat u vlerësuan nga një juri e pavarur me ekspertë të fushës së ekonomisë dhe zhvillimit të biznesit, e cila përzgjedhi fituese idetë e mëposhtme:

**LOT 1: Ide Biznesi në Fazë Konceptuale**

**Marçela Tringaj me "Purteka. Kopshtaria për fëmijë"**

Ideja e biznesit konsiston në një dyqan "shëtitës" për shitjen e produkteve si: libri "Kopshtaria për fëmijë" që përmban projekte për mbjelljen e 38 bimëve në vazo e në kushte shtëpie, paketa me fara bimësh të konsumueshme, shoqëruar me një doracak dhe udhëzues për tu përdorur nga fëmijët në kushtet e shtëpisë, si dhe objekte të tjera kopshtarie si çanta "tote bags", ujitëse, hotele bletësh, ushqyese të zogjve të lirë, fidanë lulesh, perimesh e pemësh, etj.

**Leonida Palushaj me "Clay Play LAB"**

Ideja konsiston në krijimin e një punishteje për përgatitjen e produkteve të qeramikës. Punishtja do të shërbejë si një hapësirë komunitare për organizimin e klasave rezidenciale, kurseve të mbrëmjes apo klubeve për fëmijë dhe të rritur, duke përfshirë dhe njerëzit me aftësi ndryshe fizike, të cilët mund të bëhen bashkë, të mësojnë një aftësi të re dhe të zhvillojnë kreativitetin e tyre.

Secila nga idetë fituese nën këtë Lot do të mbështetet financiarisht deri në shumën 500,000 lekë.

**LOT 2: Biznes në Fazat e Para të Zhvillimit**

**Sentiljana Marku me "Mjedrat e Danjës"**

Ideja konsiston në kultivimin e frutit të mjedrës, duke sjellë kështu një produkt të ri për zonën e Vaut të Dejës, e duke ofruar për konsumatorin një frut organik të certifikuar sipas standardit "Organic", me vlera të larta ushqyese. Përmes mbështetjes nga Konkursi synohet zgjerimi i aktivitetit në Qarkun e Shkodrës dhe atë të Lezhës, shtimi i kapaciteteve për kultivimin dhe ruajtjen, si dhe diversifikimi i produktit të mjedrës, i quajtur ndryshe dhe si "Ari i kuq".

**Ornold Bazaj me "Reality Escapers Albania"**

Reality Escapers Albania është një operator turistik që ofron shërbime turistike kryesisht në sportet në natyrë, si ecje malore (hiking), ngritja e kampeve, vëzhgimi i shpendëve (birdwatching) dhe turet me kajak në zonat përreth Vlorës.

Përmes mbështetjes nga Konkursi, Reality Escapers Albania do të ofrojë si shërbim të ri turistik turet "hiking",

të cilat përfshijnë ngjitjen në majën e Çikës, gjiret fantastike dhe të egra të Gadishullit të Karaburunit (si Gjiri i Dafinës Bristanit, Gramës dhe Shën Andreut), shpellat ujore



(si shpella Sekrete, shpellat tokësore si ajo e Duk Gjonit dhe Anglezit në Karaburun, shpellat prehistorike në fshatin Velçë); lundrimin me kajak në rrjedhën e poshtme të Lumit Vjosa dhe Lagunës së Nartës e Zvërnecit, si dhe aktivitetin e vëzhgimit të shpendëve (Birdwatching).

**Marjana Jakini me "Trendy Traditë"**

Idea "Trendy Traditë" kon-

Secila nga idetë fituese nën këtë Lot do të mbështetet financiarisht deri në shumën 800,000 lekë.

Tre prej fituesve, përkatësisht "Purteka. Kopshtaria për fëmijë", "Mjedrat e Danjës" dhe "Reality Escapers Albania" do të bëhen automatikisht pjesë e konkurrimit në nivel rajonal të Konkursit Ballkanik të Ideve të Gjëlbertha 2023 i cili do të zhvillohet në Mal të Zi në muajin tetor.



## KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

# MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

### KËSHILLA PËR PRODHUESIT E PERIMEVE

Muaji Maj është një nga periudhat më të ngarkuara të prodhuesve të perimeve, në serra e në fushë. Punohet për kryerjen e shërbimeve dhe vjeljen e prodhimit në serra, ndërkohë që vazhdon puna për përgatitjen e ngastrave me plugime, diskime apo frezime, plehërimin bazë e me mbjelljen e bimëve perimore në fushë (domate, spec, patëllxhan, shalqi, pjepër, kungull, barbutnjë, sallatë, etj, etj).

#### Cilat janë aktivitetet kryesore të kësaj periudhe?

**Në serra:** Në zonën bregdetare vazhdon puna me shërbimet dhe vjeljen e bimëve kryesore të këtyre mjedisve: domate, kastravec, spec, barbutnjë, kungull i njomë dhe patëllxhan. Me rëndësi është puna për mbrojtjen e kulturave nga sëmundjet e dëmtuesit (vrugu, kalbëzimi gri, fuzarioza, etj; dëmtues si afidet, tenja minuese, Tuta absoluta, etj), për të cilat lipset të merren kontakte të vazhdueshme me spe-

cialistët e të merret mendimi i tyre i kualifikuar. Parësore është hapja e serrave dhe ajrosja e vazhdueshme e tyre, veprim me dobi për rregullimin e mikroklimës në mjedisin e serrës, për rritjen dhe zhvillimin e mire të bimëve, mbrojtjen nga sëmundjet, sasinë dhe cilësinë e prodhimit. Plehërimi i bimëve në serra të mbështetet më mirë në treguesit fiziologjikë dhe fazën e zhvillimit të tyre. Përgjithësisht, fermerët kanë tendencë që të përdorin doza të larta plehërimi, çka nuk shkon në dobi të bimës dhe mjedisit dhe që shoqërohet edhe me shpenzime të padobishme. Nga vëzhgimet tona në shumë serra të zonës së ulët e bregdetare, shihet se ka tepri në të ushqyerit e bimëve me azot, çka i bënë ato me volum të madh gjetor, të prekshme nga

sëmundjet dhe në dëm të sasisë dhe cilësisë së prodhimit. Këshillat e specialistit duhet të udhëheqin skedën e plehërimit.

Kujdes dhe vëmendje të veçantë merr ujtja e bimëve për sigurimin e rritjes dhe zhvillimit optimal të tyre, për sasi dhe cilësi më të mirë të prodhimit. Këshillohet përdorim i ujërave të pastër, të pandotura dhe pa kripëra, me pH 6.5-7.5. Hapja dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit mbetet detyrë e përhershme.

**Në fushë:** Në bimët e mbjella në vjeshtë dhe herët në pranverë, si lakra kokë, lule lakra, brokoli, karota, prasi, qepa, hudhra, sallata, spinaqi, rukola, etj, vazhdohet me vjeljen e tyre.

Në zonën e ngrontë ka filluar dhe va-

zhdon puna për përgatitjen e ngastrave dhe mbjelljen e shalqirit, domates, specit, patëllxhanit, barbutnjës, pjeprit, kungullit, sallatës, etj. Në ngastrat ku mbillet, të tregohet kujdes për kryerjen e analizave kimike të tokës, për të bërë bilanc të ushqyerit të bimëve me qëllim që të mos shpenzohen para të tepërta me përdorim të sasive të larta të plehrave kimike, por edhe për ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe mirëmbajtjen e saj.

Në perimet e fushës këshillohet të përdoret gjerësisht mulçerimi plastik i sipërfaqes së tokës, hallkë teknologjike me mjaft avantazhe për rritjen dhe zhvillimin e bimëve por edhe me efekte ekonomike, që shton prodhimin dhe rrit cilësinë e tij, ul nevojat për punën e dorës dhe ul koston e prodhimit.

Në zonën kodrinore e paramalore ka filluar puna për përgatitjen e fidanëve dhe të ngastrave për mbjelljen e domates, specit, shalqirit, të patëllxhanit, barbutnjës, etj.

**Drejtorja e Teknologjive të Perimeve: QTTB-Lushnje**  
**E-mail: qttblushnje@yahoo.com**

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

### Informacion Teknik për Fermerët

*Çfarë është në të vërtetë një ushqim i kombinuar?*

Janë disa lloje ushqimesh të përziera së bashku, në raporte të caktuara. Idea është, që me anë të kësaj përzierje të bëhet i mundur sigurimi i të gjitha lëndëve ushqyese, përfshi këtu edhe ato minerale e vitaminoze, të domosdoshme për nevojat e mbajtjes së trupit dhe prodhimit normal të kafshës. Kafshët si në kullotë apo në rregjim stallor nuk mund t'i plotësojnë dot nevojat me të gjitha elementet ushqyese pa një kombinim të bimëve foragjere.

Në faza të ndryshme të zhvillimit të bimësisë dhe në stina të ndryshme të vitit, ka gjithmonë deficitë në drejtim të plotësisë të nevojave për kafshët, gjë që mund të çojë deri në gjendje urie të tyre.

Fermerë nëse keni marr përsipër të mbarështoni gjedhë në përgjithësi bagëti, atëherë duhet të kujdeseni që të krijoni të gjitha mundësitë për t'i plotësuar nevojat e tyre për të gjithë elementet ushqimorë. Natyrisht, kjo është e gjitha në interesin tuaj, sepse vetëm në këtë mënyrë, bëhet e mundur që kafsha të manifestojë mundësitë prodhuese të saj, pra të jetë ekonomisht e leverdishme për ju.

Me të ushqyer të ballancuar të kafshëve bujqësore (ushqime të kombin-

### USHQIMET E KOMBINUARA DHE LEVERDIA PRAKTIKE E PËRDORIMIT TË TYRE NË TË USHQYERIT E BLEGTORISË

uara) nënkuptojmë të ushqyerit e tyre me disa lloje ushqimesh të përziera në raporte të caktuara, pasi nevojat e tyre, në asnjë mënyrë nuk mund të plotësohen, duke përdorur vetëm një lloj ushqimi, sado "i mirë" qoftë ai. Është e domosdoshme pra të hartohet një racion ushqimor, duke përdorur sa më shumë përbërës dhe është pikërisht ky fakt, që na çon në sistemin e të ushqyerit me ushqime të kombinuara që të përmbajë energji, proteina, minerale dhe vitamina, në sasi të raportet e duhura, e cila është detyra e fermerit që të kujdeset për sigurimin e një racioni të plotë e të ballancuar. Në përgatitjen e ushqimeve të kombinuara, duhet të mbahej parasysh plotësimi i nevojave nga njëra anë dhe nga ana tjetër çmimi i përbërësve të tyre, në mënyrë që nga njëra anë bagëtive ti plotësohen nevojat, por nga ana tjetër racioni të kushtojë sa më lirë, bëhet i mundur shfrytëzimi me efektivitet i kapaciteteve prodhuese.

**Përbërësit e ushqimeve të kombinuara:**

- Ushqime Energjitime

- Ushqime Proteinike
- Lëndë Minerale
- Lëndë Vitaminoze
- Lëndë Plotësuese

Ushqimet më të rëndësishme energjitime për të ushqyerit e blegtorisë janë drithërat, të cilët normalisht zënë 50-80 % të racionit, por pjesën tjetër e zënë ushqimet proteinike si soja, bërsitë e lulediellit e tjerë.

Ndërsa lëndët minerale dhe vitaminat rriten kur kafshët kanë rendimente të larta prodhimi qumështi, atëherë bëhet e domosdoshme që ato të shtohen si lëndë plotësuese, ku burimi i sigurimit të tyre është Industria Kimike.

#### Kujdes!

Në qoftë se merrni përsipër t'i kombinoni vetë ushqimet, mos harroni përfshirjen në racion të sasisë së duhur të kripës së gjellës.

#### Fermerë!

Vlerësoni më shumë dhe më mirë të ushqyerit e blegtorisë, këshillohuni me specialistin, për teknologjinë e kombinimit

dhe teknikën e përdorimit të ushqimeve për blegtorinë. Mos përdorni vetëm një lloj koncentre, pasi asnjë ushqim i veçantë sado "i mirë" qoftë, nuk mund të jetë i plotë, prandaj konsultohuni me specialistin, për një kombinim sa më të efektshëm të tyre. Zgjidhja më e mirë e këtij problemi është blerja e ushqimeve të kombinuara të prodhuara nga Fabrikat e Ushqimeve për Blegtorinë, pasi në to ka edhe lëndë të tjera shtesë, të cilat ju e keni të vështirë t'i siguronit dhe praktikisht të pamundur t'i fusni në përzierjet që mund të përgatisni vetë. Jo vetëm kaq, por megjithëse në dukje "të shtrenjta", ushqimet e fabrikës janë më të lira se sa ushqimet që ju mund të "prodhoni" vetë.

#### Mos harroni!

Kafshët apo shpendët që ju mbani, duhet t'i konsideroni si "Fabrika" që punojnë për ju, por nga ana tjetër ato kanë nevojë për shërbim teknik të kualifikuar, në mënyrë që të prodhojnë me maksimumin e kapacitetit të mundshëm të tyre.

#### Fermerë!

Merrni informacionin e nevojshëm nga specialistët, që të mund të aftësoheni, për t'i trajtuar bagëtitë tuaja sa më mire! Vetëm kështu, ju do të plotësoni njohuritë tuaja, për të prodhuar çdo vit, më shumë e me cilësi, për të qenë të aftë të konkuronit në kushtet e Ekonomisë së Tregut.

**Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:**  
**E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com**



# MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

### QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

## NDIKIMI I BLEGTORISË NË MJEDIS

Blegtorja ka luajtur gjithmonë një rol të vlefshëm pozitiv ndaj mjedisit dhe së bashku me bujqësinë, ajo përbën mburojën kundër varfërimit dhe degradimit të tij. Megjithatë, duhet pranuar se praktikata e pamëshuar të blegtorisë të çojnë në mënyrë korrekte në prishjen e ekuilibrit të "blegtorisë/mjedisit" me pasoja negative, disa të menjëhershme, të tjera më të ngadalta në efekt, por jo më pak serioze dhe të rrezikshme për të. Aktiviteti blegtoral ka një ndikim të rëndësishëm në balancat mjedisore, si në nivele lokale dhe globale, në shumë aspekte, duke përfshirë ngrohjen globale, degradimin e tokës, ndotjen e ajrit, ujit si dhe në humbjen e biodiversitetit. Ky ndikim është tashmë mjaft i rëndësishëm aktualisht, por po rritet më tej si pasojë e kërkesës në rritje në mbarë botën për produkte me origjinë shtazore (mish, qumësht dhe vezë) dhe për prije gjithnjë e më e theksuar drejt intensifikimit të prodhimit blegtoral.

Ndikimi i blegtorisë në mjedis shprehet në efekte direkte dhe indirekte. Ndër efektet e drejtpërdrejta mjedisore të blegtorisë përfshihen, efektet e kullotjes, efektet e përhapjes së ujërave të zeza në tokë e ujë, konsumi i ujit, emetimi i metanit dhe gazeve të tjera në atmosferë. Ndërveprimet midis blegtorisë dhe mjedisit nuk janë gjithmonë vetëm negative, por edhe pozitive, si avantazhi i përdorimit të plehurat organik, kontributi në drejtim të energjisë motivuese që jep puna me kafshët ende shumë i rëndësishëm në shumë zona të botës.

Ndikimet indirekte lidhen kryesisht me prodhimin dhe transportin e mjeteve teknike të destinuara për mbarështim, veçanërisht ushqimit për blegtorinë. Ndikimi i blegtorisë në mjedis është bërë më i ndërlikuar nga diversifikimi ekstrem i sistemeve të mbarështimit në mbarë botën. Lloji i ndërveprimit dhe rëndësia e tij ndryshojnë shumë në varësi të sistemit të mbarështimit, të teknikave të aplikuar dhe të specieve kafshëve të kultivuara (kafshë monogastrike ose poligastrike, tokësore ose ujore). Blegtorja ndikon në modifikimin e përbërjes së gazeve në atmosferë nëpërmjet një gamë të gjerë të emetimeve të gazta duke përfshirë, kryesisht, metanin, dioksidin e karbonit, oksidin e azotit dhe amoniakun. Disa nga këto gazra, siç dihet, kanë efekte të rëndësishme në klimën e tokës që duke mbajtur rrezatimin e emetuar nga toka, ato kontribuojnë në efektin serrë, dmth ngrohjen e sipërfaqes së tokës e cila është një problem serioz për mjedisin pasi shoqërohet me fenomene si shkrija e akullit, rritja e nivelit të detit, ndryshimi i rezervave ujore, shkretëtirëzimi, ndryshimi i ekosistemeve, zhdukja e llojeve të kafshëve dhe bimëve, rritja e shpeshësisë dhe ashpërsisë së ngjarjeve ekstreme të motit. Këto dukuri mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në biznesin në të ardhmen ekonomike, bujqësi, sigurinë ushqimore dhe shëndetin e popullatës. Bujqësia dhe në veçanti blegtorja, kontribuojnë ndjeshëm dhe shtojnë problemet e gazeve serrë.

Spektori i blegtorisë është deri tani përdoruesi më i madh i tokës, blegtorja është përgjegjëse për 18% të emetimeve të gazeve serrë, më shumë se transporti. Nëse marrim parasysh sektorin e bujqësisë në tërësi, vetëm blegtorja përbën 80% të emetimeve.

Gazrat kryesore të emetuara nga fermat që kontribuojnë në efektin serrë janë: diok-

sidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), metani(CH<sub>4</sub>) dhe oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O). Sistemet ekstensive prirën të kenë një ndikim më të madh se sa ato intensive mbi emetimet e gazeve serrë.

#### Dioksid karboni

9% e emetimeve antropogjene të dioksidit të karbonit prodhohen nga blegtorja. Ky gaz i detyrohet jo vetëm zgjerimit të kullotave dhe tokës së punueshme për kulturat foragjere, por edhe përdorimit të energjisë si lëndë djegëse, si ngrohje për ndërtesat blegtorale.

Emetimet e dioksidit të karbonit rrjedhin pjesërisht drejtpërdrejt nga proceset e frymëmarrjes

si produkt i aktiviteteve metabolike të kafshëve të kultivuara. Prodhimi i CO<sub>2</sub> rrjedh gjithashtu nga përdorimi i drejtpërdrejtë i energjisë për aktivitetet dhe proceset e mekanizuara që kryhen në sektorin e blegtorisë (ajrimi, ngrohja, mjelja, shpërndarja e ushqimit, etj.) Megjithatë, blegtorja kontribuon në rrugë indirekte në emetimet e dioksidit të karbonit si nga përdorimi i energjisë për qëllime të prodhimit industrial dhe transportit të mjeteve teknike për mbarështim, si p.sh ushqim për bagëtinë, aditivë, suplemente, ilaçe dhe pajisje për blegtorinë. Një tjetër mënyrë indirekte përmes së cilës blegtorja kontribuon në prodhimin e CO<sub>2</sub> është prodhimi industrial i herbicideve, pesticideve dhe plehrave azotike, për kultivimin e foragjereve dhe ushqimit për blegtorinë. Në vendet në zhvillim, burimi i CO<sub>2</sub> vjen shpesh nga modifikimi i përdorimit të tokës si shpyllëzimi i kryer me qëllimin e transformimit zona shkurre, në kullota ose në tokë arë për prodhimin e ushqimit për blegtorinë.

#### Metani

Për nga rëndësia, metani është gazi i dytë përgjegjës për efektin serrë pas CO<sub>2</sub> dhe gjithashtu do të ishte bashkërisht përgjegjës për reduktimin e shtresës së ozonit. Rreth 37% e emetimeve antropogjene të metanit prodhohen nga blegtorja. Burimet kryesor i metanit është fermentimi enterik i kafshëve mbi të gjitha i ripërtypësve, fermentimet e plehurat organik e ujërat e zeza.

Prodhimi i metanit në nivel enterik rrjedh kryesisht nga fermentimet mikrobike të karbohidrateve të pranishme në racionin e kafshëve (celulozë, hemicelulozë, pektinë dhe niseshte) procese të cilat ndodhin në rumenin e ripërtypësve. Sasia e metanit e prodhuar nga kafshët ndikohen nga shumë faktorë, si speciet e kafshëve, niveli produktiv, përbërja e racionit, lloji i karbohidrateve të pranishëm, shkalla e ngopjes së lipideve të pranishme në racion, disa faktorë mjedisore, si temperatura, faktorë gjenetikë të tillë si efikasiteti i konvertimit të ushqimit.

#### Oksidi i azotit

Oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O) është një gaz përgjegjës si për efektin serrë ashtu edhe për hollimin i shtresës stratosferike të ozonit, e cila mbron biosferën nga efektet e dëmshme të rrezeve ultravjollcë. Është i pranishëm në sasi të vogla në atmosferë dhe është, gazi i tretë serrë, pas dioksidit të karbonit dhe metanit. Kontributi i veprimtarisë blegtorale është i konsiderueshëm, llogaritet se rreth 65% e oksidit të azotit antropogjen

rrjedh nga blegtorja dhe në veçanti nga sistemet ekstensive.

Për sa i përket blegtorisë, prodhimi i oksidit të azotit është i lidhur veçanërisht me konservimin, trajtimin dhe përdorimin e plehurat organik blegtoral i cili varet nga metoda dhe kohëzgjatja të këtyre operacioneve por edhe nga lëndë e thatë e ujërave të zeza dhe temperatura e ambientit.

Ndikimi i blegtorisë në cilësinë e ajrit nuk lidhet vetëm me ndryshimin e përbërjes së gazeve të pranishme në atmosferë, me pasojat e lartpërmendura në drejtim të ngrohjes globale dhe shiut acid, por përfshin edhe daljen e erërave të këqija për shkak të amoniakut, një problem veçanërisht i rëndësishëm në zonat ku ekziston një afërsi të konsiderueshme midis fermave blegtorale dhe vendbanimeve njerëzore. Prodhimi i aromave varet nga disa faktorë duke përfshirë speciet e kafshëve, përbërja e racionit dhe kushtet mjedisore (temperatura, lagështia, erërat, etj.)

#### Toka

Totali i zënë nga kullotat dhe kulturat e destinuara për prodhimin e ushqimit për bagëtinë është e barabartë me 70% të sipërfaqes bujqësore të botës. Efekti i aktiviteteve blegtorale në tokë përfshin efekte strukturore, kimike dhe ekologjike. Proceset e degradimit të tokës si shkretëtirëzimi, erozioni, zvogëlimi i lëndëve organike të pranishme në tokë, ngjeshja dhe kripëzimi mund të bëjnë që toka të humbasë aftësinë për të kryer funksionet e saj kryesore. Këto procese degradimi mund të shkaktohen nga praktikata e gabuara bujqësore për prodhimin e ushqimit për blegtorinë (plehërimi i pabalancuar, nxjerrja e tepërt e ujit nëntokësor për qëllime ujtie, monokulturë), kullotje jo racionale ose së fundi nga shpyllëzimi. Për sa i përket erozionit të tokës, blegtorja kontribuon në këtë fenomen drejtpërdrejt, si rezultat i shkëljes me këmbë dhe kullotjes dhe indirekt nga kultivimi i bimëve për ushqimin e bagëtive, veçanërisht kur kjo kryhet në një mënyrë intensive dhe sipas praktikave jo të vëmendshme për parandalimin e erozionit. Intensifikimi i aktivitetit blegtoral në përgjithësi shoqërohet me intensifikimin e aktivitetit bujqësor lidhur me prodhimin e ushqimit për bagëtinë e cila përkthehet në rritje të përdorimit të plehrave të cilat mund të shkojnë përtej nevojave të bimëve të kultivuara dhe përtej aftësisë së tokës për të mbajtur lëndë ushqyese. Nëse këto lëndë ushqyese janë relativisht të palëvizshme dhe pak të tretshme në ujë (të tilla si fosfatet e patretshme) ato grumbullohen në tokë duke modifikuar strukturën dhe karakteristikat e saj. Anasjelltas kur ato janë të lëvizshme (si azoti, kaliumi dhe disa forma të fosforit) ndikojnë kryesisht në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore. Bujqësia intensive, e cila shoqërohet me blegtori intensive, bazohet në një përdorim të rëndësishëm të pesticideve me rreziqet pa-suese të akumulimit në tokë dhe ndotjes së ujit të cilat kanë veti specifike që mund t'i bëjnë të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin. Rreziku i ndotjes së ujit që lidhet me aktivitetet blegtorale gjithashtu është i lidhur me ndotjen që vjen nga ujërat e zeza të proceseve të ndryshme të thertoreve, përpunimit të qumështit, fabrikave të

lëkurës.

#### Uji

Spektori i blegtorisë ka një ndikim të madh në përdorimin e ujit, cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore. Marrëdhënia midis blegtorisë dhe ujit ka të bëjë si me aspektin sasior, të lidhur me përdorimin e burimeve ujore për mbarështim dhe në atë cilësor i lidhur me rrezikun e ndotjes së ujit i shkaktuar nga mbetjet blegtorale, plehurat sintetike dhe pesticidet e përdorura në bujqësi dhe blegtori intensive. Prodhimi blegtoral ka një ndikim të fortë në disponueshmërinë e ujit, pasi konsumon më shumë se 8% të përdorimit të ujit nga njerëzit në nivel global, kryesisht për ujitjen e kulturave foragjere. Në zonat me burime të pakta ujore, sasia e ujit të përdorur për prodhimin e kafshëve mund të tejkalojë atë që përdoret për të plotësuar nevojat e njerëzve për ushqim. Blegtorja është burimi më i madh sektorial i ndotësve të ujit, kryesisht mbetjet shtazore, antibiotikët, hormonet, kimikatet e fabrikës së lëkurës, plehra dhe pesticidet e përdorura për kulturat foragjere. Uji përdoret për ujitjen të kulturave të destinuara ushqimin e bagëtive, për plotësimin e nevojave të tyre për ujë, për operacionet e mbarështimit në veçanti për pastrimin, përpunimin e lëndëve të para me origjinë blegtorale (thertore, industri bulmeti, përpunimi i lëkurës, etj.).

#### Biodiversiteti

Faktorët që ndikojnë negativisht në biodiversitet janë kryesisht ndryshimet në përdorimin e tokës, ndryshimet klimatike, futja e specieve dominuese dhe ndotja. Reduktimi i biodiversitetit të kafshëve që rezultojnë nga mbarështimi i atribuohet kryesisht rritjes së konkurrencës për sipërfaqet midis kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të egra dhe ndryshimi i përdorimit të tokës që rezultojnë në shkatërrim, fragmentim dhe degradim i habitateve të disa specieve. Përveç kësaj shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi, gjithashtu i lidhur me mbarështimin e kafshëve, ndihmojnë në reduktimin e hapësirave dhe burimeve për mbijetesën e kafshëve të egra. Komponent i rëndësishëm që ndikon në biodiversitet është humbja e burimeve gjenetike për shkak të zhdukjes së racave të blegtorisë, të cilat kanë çuar në një reduktim progresiv të racave autoktone në favor të atyre kozmopolite.

Sipas një raporti të FAO-s rekomandohen disa veprime për të ulur ndikimin e blegtorisë në mjedis.

- Restaurimi i tokës së dëmtuar, menaxhimi më i mirë i sistemeve të kullotjes, mbrojtja e zonave të ndjeshme.

- Menaxhimi i qëndrueshëm i prodhimit bujqësor dhe foragjereve, ushqim i përmirësuar i kafshëve, menaxhimi i plehurat organik për të reduktuar emetimet e metanit dhe të azotit.

- Menaxhimi më i mirë i mbetjeve të kafshëve, ushqim më i mirë për të përmirësuar përthithjen e lëndëve ushqyese, përdorim më i mirë i plehurat organik të përpunuar në tokë bujqësore.

Mbrojtja e përmirësuar e zonave të pacënuara, mirëmbajtja e lidhjes ndërmjet zonave të mbrojtura, integrimi i prodhimit të kafshëve dhe prodhuesve në planifikimin e përdorimit të tokës.

Përgatiti: Flutura Sala, Albi Shehu

**Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:**  
**E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com**



KËNDI I EKSPERTIT

# Kalendari bujqësor, muaji qershor 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

## Pamja e qiellit gjatë muajit qershor 2023

Më 1, 2 qershor - Marsi në Koshere. Planeti Mars do të kalojë përmes grumbullit

dita më e gjatë do të jetë 23 qershori me 15 orë 10 minuta ditë, lindja e diellit do të jetë në orën 5:08 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në

### Parashikimi i motit për muajin qershor 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë	Drejtimi	D	N			
1	16	25	18-28-25	0	0	6	4	VL	JJP	5	Kryesisht me re	
2	18	27	18-28-27	0	0	6	4	JJL	VL	3	Vranësira	
3	18	26	19-34-26	0	0	6	4	VL	JP	10	Kryesisht me diell	
4	19	26	18-28-26	5.3	3	6		JL	JJL	3	Vranësira të konsiderueshme me disa shira dhe ndonjë stuhi pasdite	
5	19	27	19-28-26	10.6	4	6	4	VL	V	3	Vranësira me disa shira dhe ndonjë stuhi pasdite	
6	18	26	19-28-25	0	0	6	7	VVL	VP	5	Intervale me re dhe kohë me diell	
7	18	26	20-33-26	0	0	4	6	VVL	VL	10	Diell dhe pak re	
8	19	26	20-33-26	0	0	6	6	VL	PJP	10	Pjesërisht me diell	
9	19	26	18-34-27	0	0	6	7	LVL	V	9	Pjesërisht me diell dhe e lagët	
10	17	27	17-29-25	0	0	13	9	VL	VVL	10	Pjesërisht me diell dhe pak e lagët	
11	17	29	17-30-27	0	0	13	6	PJP	PJP	10	Kryesisht me diell	
12	18	28	18-29-26	0	0	13	6	PJP	VVP	11	Pjesërisht me diell	
13	20	28	19-30-26	0	0	9	7	VP	VVP	11	Në fillim me re, pastaj kthehet dielli	
14	18	29	17-32-28	0	0	9	9	PVP	VVP	10	Një përzjerje e diellit dhe reve	
15	18	28	17-29-26	4	2	13	9	VP	VP	11	Periudhë me re dhe diell me ndonjë stuhi në zonë	
16	18	29	18-31-28	2	1	11	7	VP	VP	11	Interval i reve dhe kohë me diell me ndonjë stuhi me pika	
17	18	28	18-29-26	1	0.5	13	6	P	P	11	Pjesërisht me diell me ndonjë stuhi me pika pasdite	
18	18	29	18-31-27	0	0	11	6	PJP	PJP	11	Kryesisht me diell	
19	18	30	17-31-28	0	0	11	6	PJP	VVP	11	Plot me diell	
20	22	31	21-32-29	0	0	11	11	VVP	VVL	11	Plot me diell	
21	21	33	22-35-31	0	0	9	7	VVP	V	11	Kryesisht me diell dhe nxehtë	
22	22	33	22-34-31	0	0	9	6	PVP	V	11	Kryesisht me diell	
23	22	33	21-35-32	0	0	9	6	PVP	VP	11	Diell dhe nxehtë	
24	20	33	19-34-32	0	0	11	11	JP	JP	11	Kryesisht me diell dhe nxehtë	
25	17	30	16-31-28	0	0	19	15	PVP	VP	11	Kryesisht me diell	
26	19	29	19-30-27	0	0	19	11	VVP	V	11	Diell i bollshëm dhe shumë nxehtë	
